

BANKA E SHQIPËRISË

DEKLARATA E POLITIKËS
MONETARE PËR GJASHTËMUJORIN
E PARË TË VITIT 2007

KORRIK 2007

DEKLARATA E POLITIKËS MONETARE PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2007

KORRIK 2007

1. FJALA E GUVERNATORIT

Gjashtëmuja të parë të vitit 2007 shënoi një ecure pozitive të ekonomisë shqiptare në drejtim të konfirmimit të ritmit të programuar të rritjes ekonomike, të konsolidimit të mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik dhe të vazhdimin e reformave strukturore në ekonomi. Në tërësinë e tij, zhvillimi ekonomik ka ndjekur kuadrin e parashikuar në programin e zhvillimit ekonomik të vendit, duke respektuar objektivat kryesorë të programit trevjeçar dhe duke shënuar një hap të mëtejshëm në drejtim integritetit ekonomik e financiar në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Paralelisht me këtë, disa zhvillime specifike të kësaj periudhe kanë dëshmuar nevojën për një vëmendje të vazhdueshme ndaj rreziqeve të mundshme, si dhe për hartimin e zbatimit në kohë të politikave parandaluese, për të garantuar ekuilibrat ekonomikë të vendit dhe zhvillimin afatgjatë të tij.

Duke gjykuar mbi informacionin e disponueshëm, Banka e Shqipërisë konstaton se zhvillimi ekonomik është në linjë me projeksionet e fillimit të vitit, për një rritje ekonomike në nivelin 6 për qind. Rritja ekonomike ka një bazë të gjerë, duke u mbështetur si në kërkesën e brendshme për mallra e shërbime, ashtu dhe në atë të jashtme. Ajo reflekton zgjerimin e aktivitetit ekonomik në sektorët e shërbimeve, të transportit dhe të industrisë, ndërkohë që sektori i ndërtimit ka shënuar një ngadalësim relativ, ndërmjet të tjerash, edhe si pasojë e reduktimit të dhënies së lejeve për ndërtim. Kështu, me gjithë ngadalësimin e prishëm sezonal, indeksi i shitjeve të ekonomisë shënoi një rritje prej 14 për qind gjatë tremujorit të parë të vitit. Rritja ekonomike pasqyrohet edhe në tregues të tjerë, si rritja e shitjeve me pakicë në ekonomi, zgjerimi i të ardhurave tatimore, rritja e eksporteve, e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve në ekonomi dhe e nivelit të punësimit. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik është perceptuar edhe nga bizneset e konsumatori shqiptar, të cilët japin përgjithësisht opinione pozitive për ecurinë e tremujorit të parë dhe paraqiten optimistë për ecurinë e aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë.

Aktiviteti ekonomik gjatë kësaj periudhe është mbështetur kryesisht nga forcimi i kërkesës së brendshme, duke u reflektuar në rritje të konsumit dhe të investimeve në ekonomi. Rritja e kërkesës së ekonomisë për mallra e shërbime është ushqyer nga rritja e kreditimit të ekonomisë dhe nga kushtet monetare, të cilat mbeten ende stimuluese për aktivitetin ekonomik. Gjithashtu, konsolidimi i stabilitetit makroekonomik ka ndikuar pozitivisht në aktivitetin ekonomik, nëpërmjet rritjes së horizontit

kohor të planeve të biznesit dhe zbutjes së ciklit të konsumit të familjeve shqiptare. Këta faktorë, kanë ndikuar në ruajtjen e ritmeve të larta të kreditimit të sektorit privat. Në fund të muajit maj kjo kredi arriti në 228 miliardë lekë ose në 24,6 për qind të PBB-së së parashikuar për vitin 2007, duke konfirmuar rolin e saj si konsumatori kryesor i fondeve të ekonomisë shqiptare. Gjithashtu, edhe kërkesa e jashtme për produktet shqiptare ka shënuar rritje, duke u shoqëruar me një rritje prej 26 për qind të eksporteve shqiptare gjatë tremujorit të parë të vitit. Ambienti i përgjithshëm në shkallë botërore, i karakterizuar nga ritme të kënaqshme rritjeje në partnerët tanë kryesorë - Eurozonë dhe vendet e rajonit – ka favorizuar zgjerimin e eksporteve shqiptare.

Aktiviteti i sektorit fiskal, gjatë gjysmës së parë të vitit është karakterizuar nga rritja e të ardhurave dhe shpenzimeve por edhe nga krijimi i tepricave fiskale, kryesisht si pasojë e prapambetjes në kryerjen e shpenzimeve kapitale. Treguesit kryesorë fiskalë kanë vazhduar të kenë tendenca pozitive, por me ritme vjetore më të ngadalësuar rritjeje krahasuar me një vit më parë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në fund të muajit maj, janë mbledhur 95.6 për qind e të ardhurave të parashikuara dhe janë realizuar 83 për qind e shpenzimeve të programuara për këtë periudhë. Aktiviteti fiskal nuk ka ushtruar presion mbi kërkesën e brendshme gjatë gjashtëmuajorit të parë, por ndryshimi i sjelljes fiskale në pjesën e dytë të vitit, si pasojë e përqendrimit të shpenzimeve buxhetore dhe të huamarrjes publike, krijon premisa për forcimin e presioneve inflacioniste dhe për rritjen e luhatjeve në tregun e parasë, në këtë periudhë.

Rritja e kërkesës së brendshme është shoqëruar me zgjerimin e deficitit korent gjatë gjysmës së parë të vitit, në prani të një rritjeje të shpejtë të eksporteve dhe të importeve. Ky deficit shënoi një rritje vjetore prej rreth 40 për qind gjatë tremujorit të parë, kryesisht si pasojë e rritjes së importeve në masën 22 për qind dhe të deficitit tregtar në mallra me rreth 25 për qind. Importet për konsum të ndërmjetëm janë rritur më tepër sesa kategoritë e tjera të tyre, ndërkohë që rritja e importeve të orientuara drejt investimeve ka vazhduar të jetë e qëndrueshme. Një zhvillim për t'u theksuar në drejtim të sektorit të jashtëm është mbulimi në rritje i shpenzimeve korente me të ardhura kapitale, duke treguar se vendi po orientohet drejt financimit të deficitit korent me hyrje afatgjata të kapitalit dhe investime të huaja.

Pavarësisht rritjes së kërkesës gjatë gjashtëmuajorit të parë, presionet mbi nivelin e përgjithshëm të çmimeve kanë qenë të ulëta, si pasojë e zhvillimeve të favorshme në kahun e ofertës. Rritja vjetore në nivelin e përgjithshëm të çmimeve të konsumit, gjatë gjashtëmuajorit të parë të këtij viti është luhatur rreth vlerës 2.3 për qind, ndërkohë që inflacioni vjetor regjistroi vlerën 2 për qind në muajin qershor 2007. Ritmet më të larta të rritjes së çmimeve janë shfaqur në kategorinë e ushqimeve të përpunuara, në shërbimet e strehimit dhe në mallrat dhe shërbimet me çmime të administruara. Inflacioni i mallrave të konsumit u ndikua

dukshëm nga faktorë sezonalë të përkohshëm, që veprojnë në kahun zbritës dhe nga një balancë relative midis kërkesës dhe ofertës. Në kahun e ofertës, ndikimi pozitiv i prodhimit bujqësor vendas në inflacion është shfaqur mbizotërues ndaj efektit të çmimeve të larta të naftës, ndërkohë që pagat nuk kanë patur rritje të tepërta dhe pritjet inflacioniste kanë mbetur të ankoruara rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë. Në kahun e kërkesës, kushtet ekzistuese monetare kanë rezultuar të përshtatshme për kontrollin e inflacionit në këtë periudhë.

Ecuria e treguesve të ofertës së parasë ka evidentuar kërkesën e lartë për para gjatë vitit. Oferta e parasë ka shënuar rritje vjetore mesatare prej rreth 17.5 për qind, gjatë vitit 2007. Rritja vjetore e agregatit M2 është luhatur mesatarisht afër 12 për qind kundrejt normave mesatare të rritjes prej rreth 7-8 për qind, në gjysmën e dytë të vitit 2006. Ecuria e agregatit M2 kundrejt rritjes së M3, në terma vjetorë dhe struktura valutore e ofertës së parasë, pasqyrojnë krijimin e mjeteve monetare në valutë në sektorin privat të ekonomisë. Ritmet vjetore të zgjerimit të bazës monetare në ekonomi shënojnë ecuri të qëndrueshme, në rreth 10-12 për qind.

Pavarësisht nga kjo tablo, analiza e zhvillimeve aktuale dhe të pritshme ekonomike sugjeron se presionet inflacioniste mund të vijjnë duke u forcuar në periudhën afatmesme. Rritja e kërkesës së brendshme në ekonomi, prirja aktuale e zgjerimit të importeve dhe të deficitit korent, rritja e shpejtë e mjeteve monetare në ekonomi dhe prania e rreziqeve potenciale në dinamikën e pritshme të presioneve inflacioniste, bënë që Banka e Shqipërisë të shtrëngojë politikën monetare në muajin qershor, nëpërmjet rritjes me 0.25 pikë përqindjeje të normës bazë të interesit. Duke filluar nga data 28 qershor, norma bazë e interesit të aplikuar në marrëveshjet e riblerjes është 5.75 për qind. Me anë të kësaj rritjeje, Banka e Shqipërisë synon stabilizimin e pritjeve inflacioniste nëpërmjet minimizimit të rreziqeve potenciale që prekin ekuilibrin monetar dhe atë makroekonomik. Përcjellja e këtij sinjali në tregjet financiare, do të nxitë një ribalancim të prirjes aktuale rritëse të kredisë së brendshme, në favor të financimit të rritjes së qëndrueshme të ekonomisë në periudhën afatgjatë.

Nëpërmjet administrimit të likuiditetit, operacionet monetare të Bankës së Shqipërisë kanë synuar minimizimin e luhatjeve të normave të interesit në tregjet financiare, në përputhje me politikën afatgjatë të saj. Në zbatim të kësaj politike dhe në varësi të luhatjeve të likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ka përdorur operacionet e marrëveshjes së riblerjes njëjavore, si në kahun e injektimit dhe në atë të tërheqjes së likuiditetit, për të sinjalizuar politikën e saj; dhe marrëveshjet e riblerjes një - dhe tremujore, për administrimin strukturor të likuiditetit në sistem. Teprica e likuiditetit dhe tendenca rënëse e normave të interesit, diktuan praninë e Bankës së Shqipërisë në kahun e tërheqjes së likuiditetit në tremujorin e dytë. Ndërkohë, e njëjta logjikë, por e aplikuar në kushtet e mungesës së likuiditetit në tremujorin e dytë,

diktoi praninë e Bankës së Shqipërisë në kahun e injektimit të tij në këtë periudhë. Këto ndërhyrje kanë mundësuar minimizimin e luhatjeve të normave të interesave dhe respektimin e objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë. Në tregun valutor, kursi i këmbimit ka rezultuar relativisht i qëndrueshëm me një tendencë të lehtë nënçmuese në tremujorin e parë. Ndërkohë, leku ka fituar pikë kundrejt dollarit në tremujorin e dytë dhe ka qenë relativisht i qëndrueshëm kundrejt euros. Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor me synim stabilizimin e luhatjeve afatshkurtra në këtë treg.

Në përfundim, dëshiroj të ritheksoj se zhvillimet makroekonomike gjatë vitit 2007 kanë shënuar një ecuri pozitive në drejtim të rritjes ekonomike dhe të stabilitetit makroekonomik, kryesisht në sajë të dinamizmit të sektorit privat. Gjithashtu, kjo periudhë ka identifikuar një sërë dobësish strukturore të ekonomisë, ndër të cilat primare mbetet zgjidhja e çështjes energjitike dhe sigurimi i furnizimit me energji elektrike. Zgjidhja e shpejtë dhe përfundimtare e këtij problemi do të jetë një impuls për arritjen e ritmeve të programuara të rritjes ekonomike. Nota e mirë e marrë në përfundim të procesit të vlerësimit të rrezikut të vendit nga agjencia e mirënjohur Moody, i hap Shqipërisë dyert e tregjeve financiare ndërkombëtare dhe aksesin në fonde, që do të mbështesin nevojat e vendit për zhvillim. Gjithsesi, kjo huamarrje kërkon hartimin e planeve strategjike dhe konsistente të zhvillimit, për të garantuar përdorimin eficient dhe prioritar të fondeve. Gjithashtu, ajo kërkon ruajtjen e ekuilibrave të brendshëm makroekonomikë, të cilët garantojnë investitorët e huaj dhe ulin e koston e huamarrjes së Shqipërisë. Në aspektin e politikave ekonomike, sfida jonë e së ardhmes do të jetë garantimi i stabilitetit makroekonomik, në kushtet e rritjes së presioneve inflacioniste dhe zgjerimit të deficitit tregtar. Kjo sfidë do të kërkojë angazhimin e të dy politikave bazë ekonomike, politikës monetare dhe fiskale, si dhe koordinimin e tyre jo vetëm në fazën e hartimit por edhe në atë të zbatimit gjatë vitit ushtrimor. Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë mbetet e vendosur për të marrë të gjitha masat e duhura politike dhe rregullatore, të cilat do të garantojnë respektimin e objektivit të saj ligjor dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

2. EKONOMIA BOTËRORE

Aktiviteti ekonomik global vazhdoi të zhvillohej me ritme të kënaqshme edhe gjatë muajve të parë të vitit 2007. Rritja e lartë dhe e qëndrueshme e shumë ekonomive të vendeve në zhvillim ka qenë motori kryesor që ka çuar përpara aktivitetin ekonomik në shkallë botërore. Ndërkohë, aktiviteti ekonomik në shumë nga vendet e zhvilluara pritet të ngadalësohet, duke reflektuar në një masë të madhe rritjen nën potencial të ekonomisë amerikane. Përgjashtim në vendet e zhvilluara paraqet ekonomia e Eurozonës, zhvillimet e së cilës kanë vijuar ecurinë pozitive duke u mbështetur nga kërkesa e jashtme (eksportet) dhe nga kërkesa e brendshme.

Rritja e qëndrueshme ekonomike në nivel global, gjatë katër viteve të fundit, ka nxitur shkallën e përdorimit të kapaciteteve nga ana e bizneseve dhe ka përmirësuar situatën në tregjet e punës. Shkalla e lartë e përdorimit të kapaciteteve prodhuese për një periudhë relativisht të gjatë kohe, ka ndikuar në rritjen e inflacionit bazë në shumë vende, duke detyruar bankat qendrore të shtrëngojnë politikën monetare. Rritja e qëndrueshme e aktivitetit ekonomik, gjithashtu, ka ndikuar në rritjen e çmimit të produkteve të përdorimit të gjerë dhe të çmimit të naftës. Indeksi i çmimeve botërore të lëndës së parë¹ ka shfaqur prirje rritëse dhe në muajin maj, duke arritur shifrën më të lartë të nëntë muajve të fundit. Në mënyrë të veçantë, në rritjen e çmimit të këtyre produkteve kanë ndikuar normat e larta të rritjes së ekonomisë kineze dhe kërkesa e saj intensive për burime natyrore.

Tabelë 1. Disa tregues kryesorë ekonomikë në terma vjetorë (në përqindje).

| | Rritja vjetor e PBB-së, T1 | Norma e papunësisë, muaji maj | IÇK, muaji maj |
|----------|----------------------------|-------------------------------|----------------|
| SHBA | +1.9 | 4.5 | 2.4 |
| Eurozonë | +3.0 | 7.0 | 1.9 |
| Gjermani | +3.6 | 6.6 | 2.0 |
| Francë | +2.0 | 8.7 | 1.2 |
| Itali | +2.3 | 6.2* | 1.9 |
| Japoni | +2.2 | 3.8 | - 0.2 |

*Për muajin mars.

Burimi: Eurostat; BQE, Raporti i Muajit Qershor; Zyra e Kërkimeve Ekonomike.

EKONOMIA E EUROZONËS

Ekonomia e Eurozonës u rrit me rreth 3 për qind në terma vjetorë, gjatë tre muajve të parë të vitit 2007 dhe treguesit afatshkurtë sugjerojnë rritje të qëndrueshme edhe për periudhën në vazhdim. Rritja ekonomike është mbështetur nga kushtet e favorshme të kërkesës së brendshme dhe të jashtme. Ky ambient makroekonomik ka ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të tregut të punës dhe, për rrjedhojë, është reflektuar në rritjen e konsumit privat. Normat e larta të fitimeve, kushtet e favorshme të financimit dhe shkalla e lartë e përdorimit të kapaciteteve kanë mbështetur procesin e investimeve nga ana e bizneseve. Pritjet pozitive për të ardhmen mbështeten edhe nga tregues të ndryshëm, të rezultuar nga vrojtime pranë aktorëve të ekonomisë evropiane².

Duke filluar nga muaji dhjetor 2006, Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka filluar të ndjekë një politikë më të shtrënguar monetare, me qëllim ankorimin e pritjeve afatmesme për inflacionin në linjë me stabilitetin e çmimeve. Lulahshmëria e çmimit të naftës, rritja e taksës së vlerës së shtuar në Gjermani dhe presionet e krijuara nga aktiviteti i lartë ekonomik, kanë shtuar rreziqet për ecurinë e inflacionit në periudhën afatmesme. Në mbledhjen për politikën monetare, të muajit qershor, Këshilli Drejtues i BQE-së vendosi të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, duke e çuar atë në nivelin 4 për qind.

EKONOMIA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

Ekonomia Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndodhet në fazë tranzitore. Pas një periudhe disavjeçare rritjeje të lartë ekonomike, ekonomia amerikane ka shfaqur shenja ngadalësimi që prej gjysmës së dytë të vitit 2006. Gjatë tremujorit të parë të vitit, PBB-ja u rrit me rreth 2 për qind në terma vjetorë, nga 3 për qind që ishte gjatë periudhës paraardhëse. Ngadalësimi ekonomik është i lidhur me zhvillimet e vakëta të investimeve dhe të kërkesës në tregun e banesave. Gjithashtu, kontribut negativ në PBB kanë dhënë eksportet neto dhe inventarët. Frenimi i aktivitetit në sektorin e ndërtimit dhe në atë të tregut të banesave nuk është reflektuar në mënyrë të ndjeshme në ecurinë e sektorëve të tjerë të ekonomisë. Punësimi ka vazhduar të rritet, pasi ulja numrit të vendeve të punës në sektorin e ndërtimit të banesave është kompensuar nga hapja e vendeve të reja të punës në sektorë të tjerë të ekonomisë.

Inflacioni bazë vazhdon të jetë më i lartë se niveli i dëshiruar dhe papunësia më e ulët se niveli i vlerësuar si i qëndrueshëm. Në këto kushte, Rezerva Federale ka lënë të pandryshuar normën bazë të interesit në 5.25 për qind, që nga muaji qershor i vitit 2006. Për periudhën në vijim, vlerësohet se si rezultat i prirjes së lartë të produktivitetit dhe i ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, presionet inflacioniste në ekonomi do të jenë më të ekuilibruara.

EKONOMITË E VENDEVE TË RAJONIT

Zhvillimi ekonomik i vendeve të rajonit ishte i kënaqshëm në vitin 2006. Ato regjistruan një rritje ekonomike mesatare prej 5.1 për qind. Investimet e huaja direkte luajtën një rol të rëndësishëm në këtë rritje, gjë që u pasqyrua në progresin e procesit të privatizimit dhe në klimën e përmirësuar të biznesit. Megjithatë, rritja ekonomike pritet të ngadalësohet lehtësisht gjatë vitit 2007, duke arritur në 5 për qind. Kërkesa e brendshme, kryesisht konsumi privat dhe investimet, mbeten burimet kryesore të zhvillimit në rajon, ndërkohë që edhe kërkesa e jashtme pritet të luajë një rol në rritje në zhvillimin ekonomik gjatë vitit 2007. Për vitin 2008 pritshmëritë janë për një përmirësim në ritmin mesatar të rritjes ekonomike në terma vjetorë, me 0.2 pikë përqindjeje.

Fillimi i vitit 2007 i përballi disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor³ me probleme gjeopolitike, duke ndikuar ecurinë e ekonomisë së tyre. Mbi të gjitha, përcaktimi i statusit përfundimtar të Kosovës mbetet problemi më i spikatur në rajon. Në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, partia më e madhe etnike shqiptare, bojkotoi Parlamentin. Ndërsa zgjatja e procesit të formimit të qeverive të reja në Bosnje-Hercegovinë dhe në Serbi, si dhe zgjedhjet e ardhshme në Kroaci, mund të ndikojnë performancën ekonomike të këtyre vendeve.

Tabelë 2. Disa tregues kryesorë të vendeve të rajonit.

| Vendet | PBB (në %) 2006 | IÇK (në %) | Kursi këmbimit: | | Interesa (në % ⁴) | |
|--------|--------------------|---------------|-----------------|------|-------------------------------|----------|
| | | | euro | usd | kredi | depozita |
| Kosovë | 3 | 0.3 (Prill) | -- | 1.35 | 13.72 | 3.4 |


| | | | | | | |
|----------|-----|-------------|-----------|-----------|-------|------|
| Greqi | 4.4 | 2.6 (Maj) | -- | 1.35 | 4.06 | 3.74 |
| Itali | 1.9 | 1.5 (Maj) | -- | 1.35 | 4.95 | 2.42 |
| Maqedoni | 4.0 | 1.0 (Prill) | 61.19 MKD | 45.59 MKD | 10.3 | 4.7 |
| Kroaci | 4.6 | 2.2 (Maj) | 7.31 Kn | 5.44 Kn | 7.44 | 4.13 |
| Serbi | 5.4 | 4.4 (Maj) | 80.73 CDS | 59.18 CDS | 13.01 | 4.60 |

Burimi: Buletinet e bankave qendrore të vendeve përkatëse, FMN.

ECURIA E KURSIT TË KËMBIMIT

Kursi efektiv i euros⁵ është vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme, gjatë muajve të parë të vitit 2007. Në një masë të madhe, vlerësimi i euros ka ardhur si pasojë e luhatjeve të monedhës amerikane. Vlerësimi i monedhës evropiane kundrejt dollarit amerikan ka qenë gradual dhe ka filluar që gjatë tremujorit të fundit të vitit 2006. Në 25 prill 2007, një euro u këmbye me 1.36 dollarë amerikanë, duke shënuar vlerën më të lartë historike të këmbimit midis dy monedhave. Zhvillimet pozitive në ekonominë e Eurozonës kundrejt moderimit të aktivitetit ekonomik në Shtetet e Bashkuara, kanë përcaktuar pritjet në tregjet valutore dhe tendecën kryesore të kursit të këmbimit midis këtyre dy monedhave.

Grafik 1. Ecuria e kursit spot të këmbimit dollarë/euro dhe kursin nominal efektiv i euros dhe dollarit.




Burimi: BQE; Rezerva Federale e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

ÇMIMET E NAFTËS

Çmimi i naftës është rritur gradualisht që nga fillimi i vitit 2007, dhe në fund të muajit qershor arriti nivelin më të lartë për këtë vit, ku një fuçi naftë e papërpunuar u shit për rreth 71 dollarë amerikanë. Mungesa e harmonizimit të rritjes së kërkesës, prodhimit dhe kapaciteteve të tepërta e inventarëve, të vendosura këto në një ambient të pasigurt gjeopolitik, shpjegon ecurinë e çmimit të naftës edhe gjatë këtyre muajve të fundit. Kërkesa botërore për naftë pritet të rritet me 2 për qind për vitin 2007, ku vendet në zhvillim parashikohet që afërsisht ta dyfishojnë kërkesën për naftë, krahasuar me vitin 2006. Nga ana tjetër, vazhdon pasiguria për ecurinë e prodhimit të naftës si nga vendet e OPEC-ut, ashtu edhe nga vendet e tjera. Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (IEA) vlerëson

Grafik 2. Ecuria e çmimit të një fuçje naftë të papërpunuar (në usd).



se, edhe në të ardhmen, prodhimi nga vendet e joanëtare të OPEC-ut nuk do të jetë në nivelet e pritura dhe kërkesa kryesore për naftë do të vazhdojë të plotësohet nga OPEC-u. Në këto kushte, çmimi i naftës pritet të mbetet i lartë dhe i luhatshëm, duke reflektuar ndryshimet e papritura në ofertë e në kërkesë, dhe pasigurinë gjeopolitike.


3. EKONOMIA SHQIPTARE NË GJASHTËMUJORIN E PARË

Gjashtëmuajori i parë i vitit 2007 është karakterizuar nga rritja e kërkesës së brendshme në ekonominë e vendit. Kjo rritje është favorizuar nga stabiliteti makroekonomik, nga rritja ekonomike, e cila është reflektuar në rritje pagash dhe në pritshmëri pozitive për to, dhe nga kushtet e favorshme monetare. Kërkesa e lartë është mbështetur nga rritja e kredisë për individët dhe bizneset, e cila nga ana e saj ka reflektuar normat relativisht të ulëta të interesit dhe zhvillimin e shpejtë të sistemit bankar.

Kërkesa në rritje është reflektuar në ecurinë e një sërë treguesve makroekonomikë, si: rritja e punësimit; rritja e shitjeve të ekonomisë; dhe zgjerimi i deficitit tregtar.

Në bazë të ecurisë së shitjeve, prodhimi sipas sektorëve të ekonomisë vlerësohet të jetë në nivele të krahasueshme me ato të tremujorëve të parë të dy viteve të kaluara. Rritja vjetore e shitjeve në tremujorin e parë shënoi rreth 14 për qind. Kontributin më të madh në rritjen e shitjeve ka vazhduar ta japë sektori i tregtisë dhe i shërbimeve të hoteleve dhe

Grafik 3. Rritja e shitjeve dhe kontributi sipas sektorëve (në pikë përqindjeje).



restoranteve, ndërkohë që sektori i industrisë është paraqitur në nivele relativisht të larta, në krahasim me vitet e kaluara. Kërkesa për energji elektrike gjatë gjashtëmuajorit të parë, në kushtet e kufizimeve të theksuara në prodhim, është përballur me rritje të importeve të energjisë. Vlera e shitjeve përfundimtare të firmave të ndërtimit ka qenë pothuajse e njëjtë me atë të tremujorit të parë të vitit të kaluar. Rritja vjetore në sektorët e transportit dhe telekomunikacionit mbetet modeste. Vlerësimet e deritanishme për sektorin e bujqësisë sugjerojnë që rritja vjetore në këtë sektor do të jetë pothuajse e njëjtë me ritmin e vitit të kaluar.

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti, numri i të punësuarve shënon një rritje vjetore me rreth 2

mijë persona, ndërkohë që norma e papunësisë vazhdon të shënojë rënie të lehta nga tremujori në tremujor duke u ndalur në 13.6 për qind, në fund të muajit mars.

Deficiti korent shënoi një rritje vjetore prej rreth 40 për qind gjatë tremujorit të parë, kryesisht si pasojë e rritjes së importeve dhe të deficitit tregtar në mallra me rreth 25 për qind. Importet për konsum të ndërmjetëm janë rritur më tepër sesa kategoritë e tjera të importeve, ndërkohë që rritja e importeve të orientuara drejt investimeve ka vazhduar të jetë e qëndrueshme. Një zhvillim për t'u theksuar në drejtim të sektorit të jashtëm është mbulimi në rënie i shpenzimeve korente me të ardhura korente. Gjatë vitit 2006, ky raport ishte rreth 85 për qind, ndërkohë që në tremujorin e parë të vitit 2007 ai rezultoi rreth 80 për qind. Vendi po orientohet drejt financimit të deficitit korent me hyrje afatgjata të kapitalit dhe investime të huaja. Një tregues tjetër që flet për rritje të konsumit është ai i tregtisë me pakicë. Ky tregues ka shënuar një rritje prej rreth 10 për qind gjatë tremujorit të parë, ndërkohë që numri i të punësuarve në këtë aktivitet është rritur me 20 për qind.

Sektori fiskal është karakterizuar nga një ecuri e ngadaltë e shpenzimeve publike, kryesisht e atyre kapitale, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit, duke mos ushtruar presion për rritje të kërkesës. Rezultati fiskal gjatë pesë muajve të parë të vitit ishte një suficit në masën rreth 2 për qind të PBB-së. Profili i sjelljes fiskale pritet të ndryshojë gjatë gjashtëmuajorit të dytë të këtij viti, si pasojë e përqendrimit të shpenzimeve gjatë muajve të fundit të vitit, duke sjellë një rritje të stimullit fiskal në ekonomi.


Pavarësisht rritjes së kërkesës gjatë gjashtëmuajorit të parë, vlerësohet se presionet mbi nivelin e përgjithshëm të çmimeve kanë qenë të ulëta si pasojë e zhvillimeve të favorshme në kahun e ofertës. Rritja vjetore në nivelin e përgjithshëm të çmimeve të konsumit gjatë gjashtëmuajorit të parë të këtij viti është luhatur rreth vlerës 2.3 për qind, ndërkohë që tremujori i parë është karakterizuar nga një normë mesatare rritjeje më e lartë se i dyti. Ritmet më të larta të rritjes së çmimeve janë shfaqur në kategorinë e ushqimeve të përpunuara, në shërbimet e strehimit dhe në mallrat dhe shërbimet me çmime të administruara. Politika monetare ka qenë neutrale gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Gjithsesi, Banka e Shqipërisë ka theksuar në vazhdimësi rrezikun në rritje mbi stabilitetin e çmimeve si pasojë e rritjes së kërkesës së brendshme dhe ndikimit të saj në zgjerimin e shpejtë të mjeteve monetare në ekonomi. Në këto kushte, ajo rriti me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit në fund të muajit qershor, duke e çuar këtë normë në nivelin 5.75 për qind.

3.1 PRODHIMI SIPAS SEKTORËVE TË EKONOMISË

INDUSTRIA DHE ENERJITIKA

Shitjet në sektorin e industrisë shënuan një rritje vjetore prej 17 për qind gjatë tremujorit të parë të vitit 2007, rritje kjo e përafërt me

Grafik 4. Kontributi i nënsektorëve industrialë në rritjen vjetore të sektorit të industrisë.



Burimi: INSTAT, Indeksi i shitjeve, qershor 2007.


mesataren e vitit të kaluar. Kontributi vjetor i këtij sektori në shitjet totale të ekonomisë rezultoi pozitiv, me rreth 4.4 pikë përqindje. Në terma të ndryshimeve tremujore, shitjet e sektorit të industrisë sezonalisht të rregulluara janë rritur me 2 për qind gjatë tremujorit të parë të vitit 2007, duke dëshmuar për zhvillime të qëndrueshme të aktivitetit ekonomik në këtë sektor.

Në këtë ecuri kontribuan pozitivisht të dy nënsektorët kryesorë, industria nxjerrëse dhe ajo përpunuese, përkatësisht me 4.1 dhe 12.5 për qind. Si rrjedhim i gjallërimit gradual të aktivitetit në industrinë nxjerrëse, kjo e fundit ka vijuar të manifestojë një rritje të dukshme të kontributit të saj në shitjet totale të ekonomisë. Një shtysë të ndjeshme në shitjet e këtij sektori

ka dhënë rritja e eksporteve. Në terma vjetorë, vëllimi i eksporteve të industrisë nxjerrëse është dyfishuar. Industria përpunuese dominon ecurinë e shitjeve në industri, duke siguruar rreth 64 për qind të shitjeve totale të industrisë dhe 17 për qind të shitjeve në nivel ekonomie. Ajo pati një aktivitet eksportues në nivele pothuaj të njëjta si edhe një vit më parë. Rreth 30 për qind e shitjeve në këtë industri u realizua në tregun e jashtëm. Situatën relativisht pozitive të tremujorit të parë të këtij viti, e shprehur në rritjen e nivelit të eksporteve e të punësimit dhe në përmirësimin e gjendjes financiare, e mbështesin edhe rezultatet e treguesve të besimit të biznesit, të sektorit të prodhimit industrial.

Shitjet nominale të energjisë, ujit dhe gazit në tremujorin e parë të vitit rezultuan 4 për qind më të larta se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Ndërkohë, prodhimi në vend i energjisë elektrike shënoi rënie të

Grafik 5. Burimet dhe përdorimet e energjisë elektrike, sipas zërave përbërës në GWH.



Burimi: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, prill 2007.

theksuar vjetore - rreth 51.2 për qind - gjatë periudhës janar-maj 2007, kryesisht si pasojë e situatës së pafavorshme hidrike. Në këto kushte, për të furnizuar vendin me energji, KESH është detyruar të pesëfishojë importin e energjisë në terma vjetorë. Ndërkohë që janë importuar 1.4 miliardë kwh energji, pritet që deri në fund të vitit të importohen edhe rreth 1 miliard të tjera. Nivelet e ulëta të prodhimit dhe ato të larta të importit, kanë ndikuar negativisht në bilancin financiar të KESH.

Konsumi familjar dhe ai jofamiljar kanë patur rënie gjatë kësaj periudhe, duke qenë respektivisht 3.3 dhe 1.9 për qind më të ulët se një vit më parë. Masat administrative të ndërmarra nga KESH ndikuan në rritjen e arkëtimeve, ndërkohë që humbjet në rrjet shënuan një ulje vjetore me rreth 21 për qind. Megjithë masat që janë marrë dhe pritet të merren për përmirësimin e situatës energjitike në vend, përsëri bëhet e ditur nga KESH se kufizimet në furnizimin me energji do të jenë të pranishme edhe në vazhdim, duke nënvizuar përmasat e problemit të energjisë elektrike dhe prioritetin që duhet të marrë zgjidhja e tij.

NDËRTIMI


Të dhëna zyrtare sipas vëllimit të shitjeve si edhe ato të siguruara nga vëllimet periodike të Bankës së Shqipërisë pranë firmave, tregojnë se aktiviteti i ndërtimit në vend ka manifestuar rënie të theksuar gjatë tremujorit të parë të këtij viti. Tremujori i parë i vitit 2007 shënoi një kontribut rreth 31 për qind më të ulët se sa ai i një viti më parë në vëllimin total të shitjeve. Po kështu, në terma të ndryshimeve tremujore, shitjet sezonalisht të rregulluara rezultuan rreth 40 për qind më të ulëta. Në tkurrjen e aktivitetit në këtë sektor gjykohet të ketë patur një ndikim të rëndësishëm rënia e lejeve të ndërtimit, ndërkohë që vlerësohet se kërkesa për ndërtime është ende e lartë. Kjo konfirmohet edhe nga vlerat e larta pozitive të serisë së balancës për treguesin e kërkesës, të rezultuara nga deklaratimet e firmave ndërtuese përgjatë gjithë vëllimeve të besimit të biznesit.

Niveli i lartë i kërkesës dhe oferta e kufizuar në lejet e ndërtimit, janë pasqyruar në çmimet e larta të banesave. Norma vjetore e rritjes së indeksit të çmimit të banesave⁶ rezultoi 17 për qind për tremujorin e parë 2007 apo disa pikë përqindjeje më e lartë se sa mesatarja e pesë viteve të fundit. Nga ana tjetër, norma e rritjes vjetore të indeksit të kushtimit në ndërtim rezultoi vetëm 3 për qind, fakt që tregon se çmimet në ndërtim diktohen në pjesën më të madhe nga rritja e raportit kërkesë / ofertë se sa nga rritja e kostove të prodhimit.

SHËRBIMET


Aktiviteti tregtar, i hotelierisë dhe i restoranteve, si pjesa më e rëndësishme e sektorit të

Grafik 6. Rritja vjetore e indeksit të kushtimit në ndërtim, të çmimit të banesave dhe të shitjeve (në %).



Burimi: IKN, INSTAT 2007 dhe ICB është llogaritje e Bankës së Shqipërisë

shërbimeve, regjistroi norma vjetore rritjeje të qëndrueshme të vëllimit të shitjeve, për të pestin vit rradhazi. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2007, rritja vjetore e vëllimit të shitjeve rezultoi 14.7 për qind. Pothuajse ½ e kontributit në rritjen e përgjithshme të shitjeve në ekonomi i atribuohet këtij nënsektori. Aktiviteti i tregtisë është ai që vijon të ketë peshën më të lartë në shitjet totale të ekonomisë, 44 për qind.



Vëllimi i punës në tregtinë me pakicë, sipas të dhënave të Indeksit të Tregtisë me Pakicë (INSTAT, 2007), paraqitet me ecuri pozitive në terma vjetorë, si për këtë tregues (11 për qind) ashtu edhe për numrin e të punësuarve në këtë sektor (20 për qind). Zhvillimet e mësipërme janë tregues që mbështesin rritjen e konsumit dhe të kërkesës së brendshme në ekonomi për periudhat krahasuese.

Sektori i transportit gjatë tremujorit të parë 2007, evidentoi një rritje vjetore të shitjeve, me rreth 49 për qind, duke shënuar një kthesë pozitive në prirjen rënëse të katër tremujorëve paraardhës. Ndonëse pesha e këtij nënsektori në vëllimin total të shitjeve është e vogël, rritja e lartë vjetore e tij kontribuoi me rreth 1.6 pikë përqindjeje në rritjen vjetore të shitjeve në ekonomi. Ecuri pozitive u evidentua edhe në termat e ndryshimeve tremujore, ku shitjet sezonalisht të rregulluara shënuan një rritje prej 14 për qind, krahasuar me tremujorin paraardhës. Këto zhvillime mbështeten edhe nga një pjesë e të dhënave të vëllimit të punës në transportin ajror dhe detar.

Tabelë 3. Tregues të transportit hekurudhor, detar dhe rrugor.

| Aktiviteti | Njësia | T1-06 | T1-07 | Ndryshimi vjetor (në %) |
|-----------------------|----------------|-------|-------|-------------------------|
| Transporti ajror | mijë pasagjerë | 466.7 | 405.3 | 26 |
| Transporti ajror | mijë fluturime | 18.2 | 22.4 | 23 |
| Transporti hekurudhor | mijë ton | 115 | 73 | -37 |
| Transporti detar | mijë pasagjerë | 138 | 165 | 20 |
| Transporti urban | mijë udhëtarë | 5 | 4.8 | -5.5 |

Burimi: Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, korrik 2007.

Sektori i telekomunikacionit në tremujorin e parë të vitit 2007, shënoi rënie pas një ecurie pozitive gjatë gjysmës së dytë të vitit të kaluar. Ndryshimi vjetor real i indeksit të shitjeve për telekomunikacionin⁷ shënoi një rënie me 3 për qind, krahasuar me rritjen prej 27 për qind, të tremujorit paraardhës.

Shërbimet e tjera, duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2005, kanë rritur në mënyrë graduale ndikimin e tyre në shitjet totale të ekonomisë. Kontributi i tyre në rritjen vjetore të shitjeve në ekonomi, për këtë

tremujor, rezultoi rreth 2 pikë përqindje. Ecuria e qëndrueshme e sektorit të shërbimeve në terma vjetorë, mbështetet edhe nga rezultatet e vërtetimit të besimit të biznesit, ku opinionet e firmave të sektorit të shërbimeve ishin më pozitive, se sa ato të sektorëve të tjerë.

BUJQËSIA

Ecuria në sektorin e bujqësisë gjatë pjesës së parë të vitit 2007 dhe në vijim, pritet të ndjekë të njëjtat ritme si ato të një viti më parë.⁸ Ky vlerësim mbështetet edhe nga kushtet e favorshme klimaterike, në periudhën janar-qershor 2007. Faktorët më të rëndësishëm që pritet të mbështesin rritjen e prodhimit bujqësor janë rritja e rendimentit, shtimi i sipërfaqes së serrave dhe faktorë të tjerë që lidhen me ndryshimet potenciale në strukturën e prodhimit për sektorin e bujqësisë. Prodhimi total bujqësor, kryesisht për shkak të prodhimit të lartë të frutave, është rritur në terma vjetorë me 3.4 përqind në vitin 2006.

Prodhimi në sektorin e agroindustrisë, pritet të rritet me 12 përqind gjatë vitit 2007. Ecuria pozitive e tij në muajt e parë të vitit 2007, është shprehur në frenimin e ritmit rritës të importeve me origjinë agroindustriale. Situatë e ngjashme paraqitet edhe me importet bujqësore të papërpunuara, norma vjetore e rritjes së të cilëve ka ardhur në rënie.


3.2 SEKTORI FISKAL

Aktiviteti i sektorit fiskal gjatë gjysmës së parë të vitit është karakterizuar nga rritja e të ardhurave dhe shpenzimeve, por edhe nga krijimi i tepriceve fiskale si pasojë e prapambetjes në kryerjen e shpenzimeve kapitale. Treguesit kryesorë fiskalë kanë vazhduar të kenë tendenca pozitive, por me ritme vjetore më të ngadalësuara rritjeje, krahasuar me një vit më parë.

Tabelë 4. Ritmet e rritjes vjetore të treguesve fiskalë gjatë 5-mujorit të parë (në përqindje).


| | 5M 2004 | 5M 2005 | 5M 2006 | 5M 2007 | Mesatare |
|-------------------------------|---------|---------|---------|---------|----------|
| Totali i të ardhurave | 8.5 | 8.2 | 13.0 | 7.5 | 8.7 |
| Të ardhura tatimore | 11.1 | 8.0 | 15.0 | 9.0 | 9.3 |
| Të ardhura nga pushteti lokal | 18.2 | 7.4 | -8.8 | -4.7 | 2.9 |
| Të ardhura buxheti i pavarur | 9.9 | 12.2 | 12.5 | -0.4 | 10.7 |

Grafik 8. Ndryshimi vjetor i prodhimit bujqësor total dhe sipas sektorëve, në përqindje*.



Burimi: Ministria e Bujqësisë, e Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, prill 2007.
*Për vitin 2007, për agroindustrinë është paraqitur parashikimi i ministrisë përkatëse.

Grafik 9. Ndryshimi vjetor i importeve dhe eksporteve të produkteve bujqësore të papërpunuara, në përqindje.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

| | | | | | |
|-----------------------------|-------|-------|--------|-------|-------|
| Të ardhura jotatimore | -11.8 | -2.1 | 7.8 | -9.0 | 4.5 |
| Totali i shpenzimeve | | | | | |
| Totali i shpenzimeve | 6.6 | 7.9 | -8.1 | 13.3 | 6.6 |
| Shpenzime korente | 7.7 | 7.2 | -4.6 | 10.0 | 6.3 |
| Shpenzime kapitale | -1.1 | 14.0 | -34.4 | 49.8 | 9.7 |
| Deficiti | | | | | |
| I brendshëm | -12.0 | 5.0 | -266.8 | -35.4 | -66.9 |
| I huaj | -13.5 | -18.2 | -48.9 | -38.3 | 2.9 |

Burimi: Ministria e Financave.

Grafik 10. Treguesit kryesorë fiskalë për periudhën janar–maj (në miliardë lekë).




Burimi: Ministria e Financave, qershor 2007.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, deri në fund të muajit maj, janë mbledhur 95.6 për qind e të ardhurave të parashikuara dhe janë realizuar 83 për qind e shpenzimeve të programuara, për këtë periudhë. Ndërkohë, për të dytin vit rradhazi, financat publike e mbyllën pesëmuajorin e parë të vitit me një bilanc pozitiv, duke arritur një suficit prej 6.7 miliardë lekësh.

TË ARDHURAT BUXHETORE

Të ardhurat buxhetore kanë shënuar një rritje vjetore prej 7.5 për qind gjatë 5 muajve të parë të vitit. Ndikimin më të rëndësishëm në këtë rritje e dha mbledhja e të ardhurave tatimore, ku performancën më të mirë e evidentuan tatimi mbi vlerën e shtuar, ai mbi të ardhurat personale dhe zëri i akcizave.

Grafik 11. Kontributi i zërave kryesorë në rritjet vjetore të të ardhurave (majtas) dhe të shpenzimeve (djathtas) për 5-mujorët (2004- 2007) (në %).



Burimi: Ministria e Financave, qershor 2007.

SHPENZIMET BUXHETORE

Shpenzimet buxhetore shënuan një rritje vjetore prej afër 13.3 për qind, gjatë pesë muajve të parë të vitit 2007. Sidoqoftë, për periudhën


referuese, janë kryer vetëm 83 për qind e shpenzimeve totale sipas programit buxhetor ose 30 për qind e shpenzimeve të planifikuara për gjithë vitin 2007. Rritja e shpenzimeve kapitale ka qenë më e lartë se sa ajo e shpenzimeve korente, por gjithsesi realizimi i tyre mbetet dukshëm larg niveleve të planifikuara. Nga ana tjetër, bilanci pozitiv i muajve të parë të vitit dhe niveli i ulët i normave të interesit kanë bërë që shpenzimet për interesat e borxhit të ulen me 0.4 për qind.

REZULTATI FISKAL

Balanca fiskale në pesë muajt e parë të vitit ka rezultuar me suficit, megjithëse në nivele më të ulëta se një vit më parë. Profili i financimit të tij sipas burimeve paraqitet i ngjashëm me atë të vitit të kaluar. Kështu, në pjesën më të madhe të vitit të kaluar u mbart një suficit i grumbulluar dhe në muajt e fundit të vitit, rritja shumë e shpejtë e shpenzimeve përshpejtoi në mënyrë të konsiderueshme rritjen e deficitit i cili u mbulua kryesisht me financim të brendshëm.

Sjellja e deritanishme e balancës fiskale, pothuaj e njëjtë me atë të verifikuar një vit më parë, shton premisat për ripërsëritjen e situatave të përqendrimit të shpenzimeve publike dhe të deficitit buxhetor, në muajt e fundit të vitit. Banka e Shqipërisë gjykon që shmangia e një skenari të tillë, do të ndihmonte në krijimin e një klime më të përshtatshme në tregun financiar dhe në përdorimin më efikas të burimeve të tij.

Grafik 12. Financimi kumulativ i deficitit buxhetor janar 2002 – maj 2007 (në miliardë lekë).




Burimi: Ministria e Financave, qershor 2007.

3.3 TREGU I PUNËS DHE I PAGAVE

Rritja e prodhimit të brendshëm është shoqëruar me përmirësime në tregun e punës. Kështu, si rezultat i rritjes vjetore të nivelit të punësimit dhe rënies së numrit të të papunëve të regjistruar në Zyrat e Punësimit, norma e papunësisë shënoi një ulje të lehtë vjetore gjatë tremujorit të parë të vitit 2007.

Megjithë rënien sezonale gjatë tremujorit të parë të vitit, punësimi në total regjistron rritje në terma vjetorë. Të dhënat e INSTAT tregojnë se numri i personave të papunë, që regjistrohen si të tillë në zyrat e punësimit, është 147.7 mijë vetë, duke shënuar një rënie me rreth 5 mijë vetë, në krahasim me një vit më parë. Edhe pse të papunët afatgjatë kanë ardhur në rënie, përsëri ata përbëjnë më shumë se gjysmën e të papunëve (57 për qind). Raporti i të papunëve

Grafik 13. Numri i të papunëve (majtas) dhe norma e papunësisë (djathtas).



Burimi: INSTAT, Konjuktura, T1, 2007.

afatgjatë ndaj të papunëve në total është afërsisht 9 pikë përqindje më pak se viti 2006. Fenomeni i papunësisë afatgjatë vazhdon të jetë më i pranishëm në grupin e personave me nivel të ulët shkollimi.

Tabelë 5. Treguesit e tregut të punës (në mijë vetë).

| | 2006 | | | | 2007 |
|-----------------------------------|-------|-------|-------|-------|-------|
| | Tr.1 | Tr. 2 | Tr. 3 | Tr. 4 | Tr.1 |
| Forca e punës gjithsej | 1,082 | 1081 | 1,084 | 1,084 | 1,080 |
| A. Të punësuar gjithsej | 931 | 931 | 934 | 935 | 933 |
| i) në sektorin shtetëror | 174 | 172 | 170 | 169 | 168 |
| ii) në sektorin privat jobujqësor | 215 | 217 | 221 | 224 | 223 |
| iii) në sektorin privat bujqësor | 542 | 542 | 542 | 542 | 542 |
| B. Papunësia | | | | | |
| i) të papunë gjithsej | 152 | 150 | 149 | 149 | 148 |
| ii) norma e papunësisë | 14.0 | 13.9 | 13.8 | 13.9 | 13.6 |

Burimi: INSTAT, Konjuktura, Tremujori I, 2007.

Niveli i pagës mesatare në sektorin shtetëror u rrit me rreth 17 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe me 1.4 përqind, krahasuar me tremujorin paraardhës.

Boks 1. Opinione të bizneseve dhe të konsumatorëve mbi pagat dhe rivlerësimin e tyre.

Në pamundësi për të patur një tregues zyrtar më të fundit për pagat dhe politikën e vendosjes së tyre në sektorin privat si edhe për të patur një ide më të qartë mbi presionet e ardhshme inflacioniste nga krahu i ofertës, Banka e Shqipërisë, gjatë tremujorit të parë të vitit 2007, organizoi një vërtetim pranë 670⁹ firmave të mëdha dhe pranë 1200¹⁰ konsumatorëve.

Rreth 45 përqind e firmave që bashkëpunuan në këtë vërtetim, u shprehën se i rishikojnë pagat me një periodicitet mesatar prej 2 vitesh, ndërkohë që pjesa tjetër nuk ndjek ndonjë rregull kohor në rishikimin e tyre. Kjo konfirmohet edhe nga përgjigjet e konsumatorëve të punësuar në sektorin privat, pjesa më e madhe e të cilëve shprehen se nuk ka ndonjë rregullsi në rishikimin e pagave. Rreth 48 përqind e konsumatorëve të punësuar, shprehen se nuk kanë asnjë forcë negociuese dhe për më tepër, nuk marrin pjesë në një proces të tillë. Profili i rishikimit kohor të pagave, ndryshon nga njëri sektor në tjetrin. Pagat në sektorin e ndërtimit janë më të luhatshme, se pagat në industri dhe në shërbime. Firmat e sektorit të ndërtimit i rishohin pagat më shpesh - rreth 60 përqind e bizneseve të këtij sektori shprehen për një rishikim të përvitshëm të pagave. Koha mesatare e rishikimit të pagave në këtë sektor është nën mesataren e ekonomisë, 1.7 vite.

Gjatë vitit 2006, 40 përqind e bizneseve dhe 31 përqind e konsumatorëve deklarojnë se nuk janë aplikuar rritje pagash. Sipas përgjigjeve të bizneseve

dhe të konsumatorëve që deklarojnë rritje pagash, rezulton se rritja mesatare e pagave shkon drejt vlerës 8.5 për qind, sipas të dy burimeve.

Përsa u takon bizneseve, është ai i sektorit të ndërtimit që ka aplikuar rritjen mesatare më të lartë të pagës, rreth 9 për qind. Firmat rivlerësojnë pagat nisur nga disa faktorë, ku më të rëndësishmit janë rezultati financiar i firmës, përdorimi i rritjes së pagës si instrument nxitës për të shtuar motivimin dhe përkushtimin në punë, konkurrenca në tregun e pagave brenda sektorit si edhe vjetërsia në punë. Ndërkohë që rritja e pagave rezulton të jetë më pak e ndjeshme ndaj faktorëve të tillë si: inflacioni i kaluar dhe ai i pritur në ekonomi, dhe rritja e pagave në sektorin publik. Edhe nga të dhënat e deritanishme, rezulton se rritja e pagave në sektorin shtetëror është më e lartë se sa ajo e deklaruar nga bizneset në këtë vrojtim. Rezultatet e mësipërme tregojnë se firmat, në përcaktimin e pagës nisen më shumë nga përmbushja e disa kushteve mikro (deri brenda sektorit) se sa nga informacioni në nivel makro (inflacioni i kaluar dhe ai i pritur). Banka e vlerëson sinjalin pozitiv në lidhje me pritjet e ulëta inflacioniste për të ardhmen, për më tepër kur ky sinjal vjen nga bizneset, si aktorët më të rëndësishëm të aktivitetit ekonomik në vend.


Deri në fund të vitit 2007, rreth 85 për qind e firmave të intervistuar, pritjet të rishikojnë/rrisin pagat, mesatarisht me 8.7 për qind. Rritjen më të lartë pritjet ta aplikojnë firmat prodhuese dhe ndërtuese, me rreth 9 për qind. Reagimi i sektorit privat të ekonomisë ndaj rritjeve të mundshme të pagave në sektorin shtetëror, pritjet të jetë i ekuilibruar. Rreth 1/2 e bizneseve të përgjigjura nuk do të ndikohen aspak (nuk do të vepronin) dhe pjesa tjetër do të reagoonte duke i rritur në mënyrë modeste pagat, në përgjigje të rritjes së tyre në sektorin publik.

Gjithashtu, edhe konsumatorët e intervistuar presin rritje pagash deri në fund të vitit 2007. Ata pretendojnë që kjo rritje duhet të jetë mesatarisht rreth vlerës 18 për qind apo 10 pikë përqindje më e lartë sesa ajo që deklarohet nga bizneset. Ky është një fenomen i njohur në procesin e rishikimit të pagave ndërmejt palëve, ku punëdhënësit (bizneset) vendosin kufij më të ulët se sa të punësuarit dhe sindikatat e tyre, për të arritur në një pikë të mesme në përfundim të procesit të negociimit. Në përcaktimin e nivelit të pritur të rishikimit të pagave, konsumatorët, vlerësojnë si faktorë të rëndësishëm, jo vetëm faktorë në nivel mikro, si edukimin dhe performancën profesionale, por edhe faktorë makro, si ecurinë e çmimeve në të ardhmen, të kursit të këmbimit, veçanërisht të atij lekë /euro.

Nisuar nga faktet e rezultuara dhe të trajtuara më sipër, Banka e Shqipërisë konsideron me kujdes si sinjalet e ardhura nga bizneset ashtu edhe ato të ardhura nga konsumatorët. Ajo thekson se ruajtja e balancave në tregun e pagave në përgjithësi, mbështet rritjen ekonomike dhe ndihmon në ankorimin e pritjeve të publikut për inflacionin, drejt objektivit të bankës qendrore.

3.4 SEKTORI I JASHTËM I EKONOMISË

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2007 deficitit korent u rrit me rreth 40 për qind ndaj tremujorit të parë të vitit 2006. Si pasojë e thellimit të deficitit korent, raporti i tij ndaj PBB-së vlerësohet të ketë arritur nivelin 14 për qind. Rritja e deficitit korent në këtë tremujor i atribuohet kryesisht rritjes së deficitit të tregtisë në mallra, i cili vlerësohet të jetë rreth 34 për qind e PBB-së.




Vëllimi i transaksioneve korentë në tremujorin e parë ishte rreth 1.8 miliardë euro, ndërsa deficitit korent shënoi vlerën 180 milionë euro. Rreth 70 për qind e shpenzimeve të përgjithshme korentë (950 milionë euro) ka shkuar për blerjen e mallrave të importit dhe pjesa e mbetur, për blerjen e shërbimeve nga ana e rezidentëve. Nga eksportet e mallrave dhe shërbimeve janë gjeneruar përkatësisht 24 dhe 36 për qind e të ardhurave korentë. Bilanci i transfertave korentë, kryesisht private, ka vazhduar të shënojë vlera pozitive. Transferrat neto kanë financuar rreth 50 për qind të deficitit të tregtisë në mallra dhe shërbime.

Deficiti i tregtisë së mallrave, gjatë tremujorit të parë, ishte rreth 8 për qind më i ulët sesa ai i tremujorit të katërt të vitit të kaluar, por rreth 20 për qind më i lartë sesa deficitit i së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Importet dhe eksportet e mallrave shënuan përkatësisht vlerat 630 dhe 180 milionë euro dhe norma e mbulimit të importeve nga eksportet rezultojnë rreth 30 për qind.

Importet e mallrave kanë shënuar një rritje vjetore prej rreth 22 për qind, ndërsa eksportet ishin rreth 26 për qind më të larta sesa në tremujorin e parë të vitit të kaluar. Nga grupimi i importeve sipas përdorimit, vërehet se pesha e atyre për konsum privat ka shënuar një rënie të lehtë në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar,

Grafik 15. Importet dhe eksportet e përgjithshme dhe importet sipas tre grupeve të përdorimit (në milionë euro).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

ndërkohë që importet për konsum të ndërmjetëm kanë shënuar normën më të lartë të rritjes, si edhe peshën më të madhe ndaj importeve të përgjithshme (rreth 50 për qind). Më tepër se gjysma e eksporteve të përgjithshme është përfaqësuar nga eksportet e tekstileve dhe ato të këpucëve, ndërkohë që tremujori i parë është karakterizuar nga një rritje e lartë e eksporteve të mineraleve. Kontribut të ndjeshëm në këtë drejtim ka dhënë rritja e eksporteve të kromit drejt Kinës.

Bilanci i shërbimeve në tremujorin e parë ka rezultuar negativ me 30 milionë euro, ndërsa ai i të ardhurave pozitiv me rreth 60 milionë euro. Llogaria e shërbimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet hyrëse dhe dalëse të udhëtimit, ndërkohë që zëri i shërbimeve të tjera ka shërbyer për të mbyllur deficitin e krijuar në kategorinë e udhëtimeve. Të ardhurat nga shpenzimet për udhëtime janë luhatur midis vlerave 170 dhe 180 milionë euro. Rënia e të ardhurave nga turizmi i atribuohet kryesisht rënies së numrit të udhëtarëve jorezidentë dhe pakësimit të kohëzgjatjes mesatare të qëndrimit. Transferrat korente, të përfaqësuara kryesisht nga dërgesat hyrëse të emigrantëve, kanë financuar rreth 50 për qind të deficitit tregtar të mallrave. Vlera e transfertave neto ishte rreth 240 milionë euro, ndërkohë që pesha e tyre ndaj PBB-së ka mbetur pothuajse e pandryshuar në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Fluksi neto në llogarinë kapitale dhe financiare gjatë tremujorit të parë ishte rreth 170 milionë euro, nga të cilat rreth 30 milionë euro kanë hyrë në formën e transfertave kapitale dhe 140 milionë, në formën e detyrimeve financiare të rezidentëve. Rritja e detyrimeve financiare të rezidentëve ndaj jorezidentëve ka ardhur si pasojë e rritjes së investimeve të huaja si edhe e huamarrjes nga jashtë. Investimet e huaja direkte gjatë tremujorit të parë janë përqendruar kryesisht në industrinë përpunuese dhe atë prodhuese, si edhe në sektorin e komunikacionit. Borxhi i jashtëm është rritur me rreth 36 milionë euro


gjatë tremujorit të parë. Rreth 90 për qind e këtij borxhi përfaqësohet nga huamarrje shtetërore. Në fund të tremujorit të parë të këtij viti, niveli i rezervave valutore të vendit ishte rreth 1.376 miliardë euro. Kjo sasi rezervash vlerësohet të jetë e mjaftueshme për mbulimin e rreth 4.4 muajve importesh të mallrave dhe shërbimeve.

4. ZHVILLIMET NË ÇMIMET E KONSUMIT

Norma vjetore e inflacionit ka qenë relativisht e ulët në tremujorin e dytë të vitit 2007. Inflacioni vjetor regjistroi vlerën 2 për qind në muajin qershor 2007, ndërkohë që tremujori i dytë i këtij viti rezultoi me një normë vjetore mesatare prej 1.8 për qind. Gjatë këtij tremujori inflacioni vjetor shfaqti një prirje rënëse, duke u ulur mesatarisht me gati një pikë përqindjeje, krahasuar me tremujorin paraardhës. Inflacioni

u ndikua dukshëm nga faktorë sezonalë të përkohshëm që veprojnë në kahun zbritës dhe nga një balancë relative midis kërkesës dhe ofertës. Kushtet ekzistuese monetare dhe bilanci fiskal i pesë muajve të parë të vitit, kanë rezultuar të përshtatshëm për kontrollin e inflacionit. Pavarësisht nga kjo tablo, pritshmëritë për ecurinë e disa treguesve të rëndësishëm monetarë dhe fiskalë për pjesën e mbetur të vitit, sugjerojnë se presionet inflacioniste mund të vijjnë duke u forcuar.

Grafik 16. Inflacioni vjetor (në përqindje).




Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

4.1 INFLACIONI SIPAS KATEGORIVE

Norma mesatare vjetore e inflacionit gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2007 ishte rreth 2.3 për qind. Tremujori i parë ka shënuar një normë mesatare dukshëm më të lartë sesa tremujori i dytë. Ecuria e normave të inflacionit të kategorive të veçanta të krijuara sipas funksionit ekonomik, ka qenë relativisht e njëtrajtshme përgjatë periudhës në shqyrtim, me përjashtim të kategorisë së “Ushqimeve të papërpunuara”. Kategoritë e tjera kanë shënuar norma pozitive vjetore të inflacionit.

Kategoria “Ushqime të përpunuara” ka regjistruar në përgjithësi, norma të larta inflacioni vjetor. Në muajin qershor, norma e inflacionit të këtij grupi shënoi vlerën më të lartë të këtij viti, prej 3.3 për qind. Në këtë muaj, inflacioni i grupit u rrit si rezultat i rritjes së çmimit të zërit “Bukë dhe drithëra”. Ky zhvillim reflektoi rritjen

Grafik 17. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindjeje).



Burimi: INSTAT dhe llogaritjet të Bankës së Shqipërisë.

e çmimit të bukës në disa nga qytetet e vendit. Inflacioni mesatar i kësaj kategorie për gjashtë muajt e parë të vitit ka shënuar vlerën 3 për qind, duke qenë disa herë më i lartë sesa inflacioni prej 0.2 për qind, i regjistruar në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në normën pozitive të inflacionit të kësaj kategorie kanë ndikuar gjithashtu rritja e akcizave për disa nga nënzërat, në muajin shtator të vitit të kaluar si edhe rritja e çmimeve të konsumit në vendet partnere.


Tabelë 6. Normat vjetore të inflacionit sipas grupeve kryesore.

| | Pije alkoolike dhe Duhan Inflacioni vjetor (%) | | | Ushqime dhe pije joalkoolike Inflacion vjetor (%) | | |
|-------------|---|-------|-------|--|-------|-------|
| | Shqipëri | Itali | Greqi | Shqipëri | Itali | Greqi |
| Qershor '06 | 1.6 | 5.2 | 4.9 | 1.9 | 1.3 | 3.5 |
| Shtator '06 | 11.4 | 5.1 | 6.7 | -1.1 | 2.5 | 4.7 |
| Dhjetor '06 | 12.1 | 5.0 | 10.7 | 0.2 | 2.7 | 4.3 |
| Mars07 | 12.2 | 5.7 | 10.8 | -0.5 | 2.4 | 2.7 |
| Prill '07 | 12.9 | 4.4 | 10.8 | -1.2 | 2.7 | 1.7 |
| Maj '07 | 13.6 | 4.4 | 8.8 | -2.0 | 2.7 | 2.0 |
| Qershor '07 | 14.3 | | 6.7 | -0.7 | | 2.2 |

Burimi: ISTAT; <http://www.istat.it>; Shërbimi Kombëtar Statistikor i Greqisë; <http://www.statistics.gr>; INSTAT, IÇK qershor 2007.

Inflacioni vjetor i kategorisë “Ushqime të papërpunuara” shënoi vlerën -2.6 për qind në muajin qershor, ndërkohë që një vit më parë kjo normë ishte 3.2 për qind. Norma mesatare vjetore e kësaj kategorie në gjashtëmuajorin e parë të këtij viti ishte -1.1 për qind, nga 2.4 për qind që ishte një vit më parë. Rënia e çmimeve të kësaj kategorie është ndikuar më së shumti nga ulja e ndjeshme e çmimeve në zërat “Fruta” dhe “Zarzavate përfshirë patate”, e cila vazhdoi edhe gjatë muajit qershor. Në ndryshim nga viti i kaluar, rritja e ofertës për këto prodhime si pasojë e hyrjes në tregun e brendshëm të prodhimeve bujqësore vendase ka sjellë uljen e çmimeve. Për më tepër, rënia e çmimeve të këtyre mallrave ka qenë këtë vit shumë më e hershme, krahasuar me një vit më parë.


Grafik 18. Inflacioni vjetor i kategorive “Ushqime të përpunuara” dhe “Ushqime të papërpunuara”.



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.


Inflacioni vjetor i kategorisë “Strehim” ka vazhduar të regjistrojë norma pozitive, por ka pësuar një rënie të lehtë në muajt e parë të këtij viti. Në muajin qershor norma vjetore e kësaj kategorie shënoi vlerën 4.1 për qind, ndërkohë që inflacioni mesatar për gjashtëmuajorin rezultoi rreth 4.5 për qind. Në krahasim me gjashtëmuajorin e parë të vitit të kaluar, vërehet se ritmet e rritjes së çmimeve të shërbimeve të strehimit, janë më të ulëta. Në përgjithësi, kjo kategori është karakterizuar nga luhatje sezonale e çmimeve, nën ndikimin e kërkesës së brendshme.

Inflacioni vjetor i kategorisë “Mallra dhe shërbime me çmime të administruara” është luhatur rreth vlerës 7 për qind, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit. Çmimi i energjisë ka ndikuar drejtpërdrejt inflacionin, nëpërmjet rritjes së kostos së energjisë së konsumuar nga familjet. Ndikimi i inflacionit të mallrave dhe shërbimeve me çmime të administruara në normën e përgjithshme të inflacionit është i konsiderueshëm. Kjo kategori ka kontribuar me rreth 0.8-1.0 pikë përqindjeje çdo muaj, që nga muaji gusht i vitit 2006. Pothuajse të gjitha shërbimet e këtij grupi kanë patur luhatje të vogla të çmimeve, gjatë pjesës së parë të vitit.




Inflacioni vjetor i kategorive “Mallra konsumi afatgjatë” dhe “Shërbime” (përkatësisht -0.9 dhe 2.7 për qind) ka rezultuar shumë afër normës mesatare vjetore prej -0.7 dhe 2.4 për qind. Ecuria e inflacionit të mallrave të konsumit afatgjatë është në linjë me prirjen në vende të tjera të botës, ku falë zhvillimit të shpejtë teknologjik, në mënyrë të vazhdueshme vërehet rritje e cilësisë dhe rënie e çmimeve. Rritja e çmimeve të shërbimeve nga ana tjetër, flet për një kërkesë dhe cilësi në rritje.

Inflacioni vjetor i kategorisë “Mallra konsumi joushqimorë” ka shënuar vlerën negative prej -0.8 për qind për muajin qershor 2007.




Norma mesatare e pjesës së parë të vitit është -0.4 për qind, ndërkohë që një vit më parë kjo kategori shënonte një vlerë mesatare prej 1.1 për qind. Rënia është manifestuar në të dyja grupet kryesore "Veshje dhe këpucë" dhe "Shërbime ndaj mjeteve personale të transportit". Inflacioni negativ i grupit "Veshje dhe këpucë" është një fenomen afatgjatë, që ka filluar që në muajin shkurt të vitit 2000. Inflacioni i grupit "Shërbime ndaj mjeteve personale të transportit" ndikohet ndjeshëm nga ecuria e çmimit të naftës në vend, i cili, nga ana tjetër, ndikohet si nga ecuria e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare, ashtu dhe nga zhvillimet në kursin e këmbimit. Rritja e çmimit të naftës gjatë kohëve të fundit, pas rënies disamujore që prej tetorit të kaluar, është kompensuar nga mbiçmimi i monedhës shqiptare ndaj asaj amerikane.



4.2 INFLACIONI DHE AMBIENTI MAKROEKONOMIK

Gjashtëmuajori i parë i vitit është karakterizuar nga rritja e kërkesës së brendshme në prani të mungesës së stimulit fiskal, kushte monetare akomoduese dhe zhvillime përgjithësisht pozitive në kahun e ofertës. Kërkesa e brendshme e lartë është reflektuar në rritje të shitjeve dhe zgjerim të deficitit tregtar. Në sferën monetare, rritja e shpejtë e mjeteve monetare dhe e likuiditetit është shoqëruar me presione për rënien e normave të interesit, ndërkohë që kursi i këmbimit ka manifestuar një stabilitet relativ. Tremujori i parë i vitit dëshmoi për rritje të aktivitetit ekonomik dhe për situatë të përmirësuar në tregun e punës, pavarësisht krizës energjitike të fillimit të këtij viti. Indeksi i shitjeve shënoi një rritje prej 14 për qind krahasuar me një vit më parë dhe norma e papunësisë vazhdoi të binte. Në kahun e ofertës, impakti pozitiv i prodhimit bujqësor vendas është shfaqur mbizotërues ndaj çmimeve të larta të naftës, ndërkohë që pagat nuk kanë patur rritje të tepërta dhe pritjet inflacioniste kanë mbetur të ankoruara rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 22. Norma vjetore dhe prirjet lineare të inflacionit bazë dhe total (në përqindje).



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Prirja rritëse e normës vjetore të inflacionit bazë përbën një tjetër sinjal informues për politikën monetare, se presionet e përhershme inflacioniste në ekonomi kanë ardhur duke u shtuar. Norma vjetore e inflacionit bazë gjatë tremujorit të dytë të këtij viti rezultoi 1.7 për qind, pothuaj e njëjtë me atë të inflacionit total. Në muajt prill dhe maj, u regjistruan norma lehtësisht më të larta të inflacionit bazë krahasuar me atë total. Ndërkohë që muaji qershor rezultoi me një inflacion bazë vjetor rreth nivelit 1.7 për qind, duke qenë më i lartë se sa ai i një muaji më parë. Këtë vlerë e ndikuan më së shumti efektet e rritjes së çmimit të bukës¹¹ dhe të disa artikujve të përpunuar ushqimorë¹².

Analiza e ecurisë së inflacionit total, tregon se shpesh ky i fundit bëhet objekt i luhatshmërisë së lartë në terma afatshkurtër. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë e vlerëson inflacionin bazë apo inflacionin “e pastruar” nga ndikimet e përkohshme, si një informacion shtesë të rëndësishëm sepse ai informon politikën monetare dhe publikun për vlerat e inflacionit të përhershëm.

Boks 2. Më shumë për inflacionin bazë dhe matjen e tij.


Inflacioni bazë përbën një informacion të rëndësishëm për procesin e analizës dhe të vendimmarrjes së politikës monetare në bankat qendrore. Literatura e përkufizon inflacionin bazë si pjesën e qëndrueshme afatgjatë të inflacionit total. Parë nga kënvështrimi i një banke qendrore, inflacioni bazë përbën atë komponent të inflacionit total, i cili shkaktohet kryesisht nga faktorë monetarë. Mbështetur në konsideratat e mësipërme teorike, inflacioni bazë do të rezultonte pasi nga inflacioni total të eliminoheshin luhatjet e afatshkurtra apo tranzitore që zakonisht shkaktohen nga faktorë jashtë sferës së veprimit të politikës monetare. Praktika e matjes së inflacionit bazë, ofron një spektër të gjerë metodash. Zgjedhja e metodës mbi bazën e së cilës arrihet një seri e përshtatshme për inflacionin bazë, përbën një pikë të debatueshme në rrethet akademike e në ato të bankierëve qendrorë (Silver, 2006). Debatet me natyrë teorike e praktike evidentojnë përparësitë dhe problemet e aplikimit të metodave të ndryshme.

Me gjithë vështirësitë dhe dilemat në përzgjedhjen e metodës për matjen e inflacionit bazë, synohet që të zgjidhet ajo metodë që: së pari, arrin të eliminojë maksimalisht luhatjet tranzitore nga inflacioni total; së dyti, të ketë një shkallë të lartë transparence, në mënyrë që ky tregues të jetë sa më i kuptueshëm nga publiku. Përvoja e pasur e bankave të ndryshme qendrore dhe veçanërisht e Bankës Qendrore Evropiane, si edhe përvoja e deritanishme në këtë fushë në Bankën e Shqipërisë, tregon se një alternativë premtuese për matjen e inflacionit bazë, është ajo e ofruar nga metoda e përjashtimit të përhershëm të disa artikujve nga shporta e konsumit. Nga krahasimi i rezultateve të metodave të ndryshme të matjes së inflacionit bazë në rastin e Shqipërisë, është vlerësuar se matja e inflacionit bazë me anë të metodës së përjashtimit të përhershëm, përmbush në mënyrë të kënaqshme, njëherësh, kriteret statistikore, të transparencës dhe të kuptueshmërisë për publikun. Në të njëjtën kohë, nëpërmjet kësaj matjeje, mundësohet parashikimi i inflacionit total në mënyrë më të përshtatshme. Megjithë përparësitë e kësaj metode, studiues të njohur të fushës përkatëse (Wynne, 2001; Cechetti, 2006) mendojnë se elimini i përhershëm i disa artikujve, jo gjithmonë mbarat brenda vetes vetëm inflacionin e përkohshëm apo tranzitor. Prandaj rezultatet e inflacionit bazë duhet të konsiderohen me kujdes si një informacion plotësues e ndihmës për të gjykuar mbi prirjen afatgjatë të inflacionit.

Bazuar në parimet dhe në përvojën e deritanishme në aplikimin e metodës me përjashtim të përhershëm, nga shporta shqiptare e konsumit janë përjashtuar: (a) mallra e shërbime me natyrë të theksuar sezonale, që shkaktojnë luhatje të larta e të përkohshme të çmimeve (zakonisht disa nga mallrat ushqimorë të papërpunuar); (b) mallra me çmime të administruara (energji dhe ujë); (c) mallra, çmimet e të cilëve shpesh janë objekt i politikës fiskale (mallrat e akcizës); (d) mallra, çmimi i të cilëve është mjaft i lidhur me konjunkturën e jashtme (nafta). Pas përjashtimit peshës e nënshportës mbi të cilën llogaritet inflacioni bazë, rezultoi rreth 78 për qind.

Prania e presioneve inflacioniste nga krahu i kërkesës është shprehur në çmimet e mallrave dhe të shërbimeve të patregtueshme¹³. Gjatë katër viteve të fundit, është regjistruar një inflacion mesatar vjetor për kategorinë përkatëse në masën 4.2 për qind, me prirje rritëse nga njëri tremujor në tjetrin për vitin 2007.

Grafik 23. Normat vjetore dhe prirjet lineare të inflacionit të mallrave të tregtueshëm dhe të patregtueshëm (në përqindje).



Burimi: INSTAT dhe llogaritjet e Bankës së Shqipërisë.

Muaji prill 2007 shënoi vlerën më të lartë të inflacionit të mallrave të patregtueshëm për gjysmën e parë të vitit, 4.8 për qind. Vlerat e larta të inflacionit të këtyre mallrave janë neutralizuar pjesërisht nga inflacioni i ulët i mallrave të tregtueshëm, i cili ka shfaqur një prirje rënëse në muajt e fundit.

Politika monetare ka vazhduar të reagojë nëpërmjet rritjes së normës bazë të interesit, duke mbetur gjithsesi akomoduese ndaj rritjes ekonomike. Në kushtet kur kërkesa e ekonomisë për mjete monetare ka vazhduar të rritet, deficitit tregtar i vendit ka vijuar të thellohet, dhe normat e interesit janë luhatur ende në nivele të ulëta, Banka e Shqipërisë vendosi të rrisë normën bazë të interesit në fundin e muajit qershor të këtij viti.

Kjo rritje u motivua me nevojën për të kontrolluar kërkesën për mjete monetare dhe efektet e rritjes së saj në perspektivën e inflacionit. Rritja e normës bazë së interesit synon nga ana tjetër, të ekuilibrojë ritmet e rritjes së kreditimit, duke administruar më mirë nivelet e likuiditetit në treg. Ajo synon gjithashtu të harmonizojë në të ardhmen kërkesën për para të sektorit privat me atë të sektorit publik, në kushtet kur ky i fundit pritet të rritet. Në këtë mënyrë, rritja e normës së interesit do të krijojë një ambient të ekuilibruar makroekonomik dhe do të sigurojë ritme të qëndrueshme rritjeje ekonomike.

Pozicioni fiskal i sektorit publik nuk ka ndikuar në rritjen e presioneve inflacioniste gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2007. Politika fiskale ka treguar kujdes në zbatimin e programit fiskal, në drejtim të mbledhjes së të ardhurave, ndërkohë që realizimi i shpenzimeve ka rezultuar në një masë më të ulët sesa niveli i parashikuar. Shpenzimet buxhetore në pjesën e parë të vitit janë rritur në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërkohë që niveli i realizimit të tyre për këtë periudhë ishte sa 30 për qind e shumës së planifikuar për vitin.

Oferta e mallrave, në mënyrë të veçantë e atyre bujqësorë, si dhe kapacitetet prodhuese të ekonomisë kanë përballuar rritjen e moderuar të kërkesës së brendshme duke mos gjeneruar presione inflacioniste.

Zhvillimet në kursin e këmbimit luajnë një rol të rëndësishëm në ecurinë e inflacionit. Tregu i brendshëm vazhdon të jetë i orientuar drejt importeve, të cilat në pjesën e parë të vitit kanë rezultuar rreth

4 herë më të larta se eksportet. Inflacioni i importuar është ndikuar pozitivisht nga stabiliteti i çmimeve në vendet partnere dhe negativisht nga dobësimi i vazhduar i lekut kundrejt monedhës evropiane. Efekti i rritjes së çmimeve të huaja në nivelin e përgjithshëm të çmimeve të konsumit në vend, vlerësohet të ketë qenë neutral. Për sa i përket prodhimit në vend, rritja e ofertës së mallrave ushqimorë, kryesisht gjatë tremujorit të dytë të vitit ka mundësuar plotësimin e pjesës më të madhe të kërkesës për këta mallra. Por, meqënëse dukuria e mësipërme ka natyrë sezonale, ambienti nënçmues i lekut ndaj monedhës evropiane do të sillte probleme serioze për normën e inflacionit në kushte kur kërkesa e brendshme e ekonomisë do të vazhdojë të mbetet e lartë në periudhën afatmesme. Çmimi i naftës, me gjithë ecurinë pozitive që ka patur gjatë pjesës së parë të vitit, ka filluar të luhetet përsëri në vlera të larta duke shtuar rrezikun, që në kushtet edhe të një krize të mundshme energjitike, të rriten kostot e prodhimit në ekonomi.

5. ZHVILLIMET MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE


5.1 POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Analiza e kushteve monetare ka evidentuar ritme të larta të zgjerimit të ofertës së parasë në ekonomi, ndërsa parashikimet e normës së inflacionit konfirmojnë prirjen rritëse të tij kundrejt normës mesatare aktuale. Norma vjetore e rritjes së ofertës monetare ka rezultuar mesatarisht 17-18 për qind në 6 muajt e fundit, kundrejt ritmeve mesatare prej 10-11 për qind në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2006. Ritmet e larta të rritjes së ofertës monetare janë mbështetur nga kërkesa e lartë për kredi nga sektori privat i ekonomisë, ndërsa pozicioni fiskal i sektorit publik ka kontribuar në zbutjen e ritmeve të zgjerimit monetar. Njëkohësisht, prania e presioneve inflacioniste është pasqyruar në rritjen e çmimeve të mallrave të patregtueshëm në tremujorët e fundit.

Efekti i kërkesës së brendshme në rritje, për mjete monetare në ekonomi është amortizuar pjesërisht në formën e thellimit të deficitit tregtar dhe atij korent. Gjatë tremujorit të parë të vitit, deficiti i llogarisë korente është thelluar me rreth 39 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2006. Të dhënat paraprake të bilancit të tregtisë për muajt prill-maj, konfirmojnë prirjen rritëse të deficitit. Në kushtet e rritjes së kërkesës së brendshme në ekonomi, prirjes aktuale të zgjerimit të pozicionit të jashtëm të ekonomisë, gjatë vitit 2007, dhe pranisë së rreziqeve potenciale në dinamikën e pritshme të presioneve inflacioniste, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në datën 27 qershor, vendosi rritjen e normës bazë të interesit me 0.25 pikë përqindjeje. Norma bazë e interesit të aplikuar në marrëveshjet (e anasjellta) e riblerjes do të jetë 5.75 për qind.

Me anë të kësaj rritjeje, Banka e Shqipërisë synon stabilizimin e pritshmërive inflacioniste nëpërmjet minimizimit të rreziqeve

Grafik 24. Ecuria e normës bazë të interesit.



potenciale që prekin ekuilibrin monetar dhe atë makroekonomik. Përcjellja e këtij sinjali në tregjet financiare do të nxitë një ribalancim të prirjes aktuale rritëse të kredisë së brendshme, në favor të financimit të rritjes së qëndrueshme të ekonomisë në periudhën afatgjatë.

Banka e Shqipërisë ka vepruar në tregjet financiare me synim ruajtjen e ekuilibrit, në përputhje me politikën afatgjatë të saj. Gjatë tremujorit të parë, operacionet monetare kanë vepruar nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes me afat të shkurtër dhe marrëveshjeve të riblerjes të anasjellta me afat më të gjatë maturimi, duke synuar stabilizimin e situatës së likuiditetit në treg. Stabilizimi i ecurisë së likuiditetit në tregun bankar është shoqëruar me rritjen graduale të

normave të interesave në tremujorin e dytë të vitit, në përputhje me politikën monetare të synuar. Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në kahun e ofertës së likuiditetit, gjatë muajit maj dhe në kahun e tërheqjes së likuiditetit, në muajin qershor, duke mundësuar minimizimin e luhatshmërive të normave të interesave. Në tregun valutor, kursi i këmbimit ka rezultuar relativisht i qëndrueshëm me një tendencë të lehtë nënçmuese në tremujorin e parë. Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor me synim stabilizimin e luhatjeve afatshkurtra në këtë treg.

Operacionet monetare kanë vepruar brenda kornizës së përmbushjes së objektivave sasiore të Bankës së Shqipërisë për qëllime të politikës monetare. Realizimi i tyre në tremujorin e tretë do të kërkojë një kuadër më të kujdesshëm të operacioneve monetare nga ana e Bankës së Shqipërisë, në drejtim të përmbushjes së objektivit të rezervës ndërkombëtare neto.

Tabelë 7. Realizimi i objektivave sasiore të Bankës së Shqipërisë¹⁴.

| | Dhjetor '06 | Mars '07 | Prill '07 | Maj '07 | Qershor * '07 | Shtator ¹⁵ '07 |
|--|-------------|----------|-----------|---------|---------------|---------------------------|
| Rezerva ndërkombëtare neto e Bankës së Shqipërisë (në milionë dollarë) | | | | | | |
| Objektivi | 1,343 | 1,318 | 1,324 | 1,331 | 1,337 | 1,459 |
| Aktuale | 1,484 | 1,487 | 1,484 | 1,458 | 1,458 | -- |
| Diferenca (A-Obj) | 141.5 | 169.4 | 159.5 | 127.6 | 121.1 | -- |
| Mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë (në miliardë lekë) | | | | | | |
| Objektivi | 79.1 | 80.6 | 80.8 | 80.9 | 81.0 | 94.6 |
| Aktuale | 78.0 | 59.3 | 57.8 | 64.6 | 68.8 | -- |
| Diferenca (A-Obj) | -1.1 | -21.3 | -23.0 | -16.3 | -12.2 | -- |
| Kredia e brendshme neto për qeverinë (në miliardë lekë) | | | | | | |
| Objektivi | 342.4 | 338.6 | 341.2 | 343.9 | 346.6 | 352.6 |
| Aktuale | 330.6 | 332.8 | 332.2 | 331.9 | -- | -- |
| Diferenca (A-Obj) | -11.8 | -5.8 | -9.0 | -12.1 | -- | -- |

*Të dhëna operative.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.2 ZHVILLIMET E AGREGATËVE MONETARË


Ecuria e treguesve të ofertës së parasë ka evidentuar kërkesën e lartë për para gjatë vitit. Oferta e parasë ka shënuar rritje vjetore mesatare prej rreth 17.5 për qind, gjatë vitit 2007. Megjithatë, zgjerimi i ofertës së parasë në ekonomi, i shprehur nga agregatët më të ngushtë monetarë, rezulton në ritme më të ulëta. Rritja vjetore e agregatit M2 është luhatur mesatarisht afër 12 për qind kundrejt normave mesatare të rritjes prej rreth 7-8 për qind, në gjysmën e dytë të vitit 2006. Ecuria e agregatit M2 kundrejt rritjes së M3, në terma vjetorë dhe struktura valutore e ofertës së parasë pasqyrojnë krijimin e mjeteve monetare në valutë në sektorin privat të ekonomisë. Ritmet vjetore të zgjerimit të bazës monetare në ekonomi (parasë rezervë) shënojnë ecuri të qëndrueshme në rreth 10-12 për qind.

Struktura valutore dhe ajo kohore e kërkesës së ekonomisë për mjete monetare, kanë gjetur balancim të mirë në strukturën e agregatëve monetarë. Prirja afatgjatë e zgjerimit të M3 është mbështetur në krijimin e mjeteve monetare në formën e kredisë për sektorin privat, ndërsa luhatjet gjatë muajve kanë pasqyruar efektin e huamarrjes së brendshme për financimin e deficitit në gjenerimin e flukseve monetare. Ecuria e balancuar e pozicionit fiskal gjatë vitit 2007, ka kontribuar në stabilizimin e ecurisë së ofertës monetare.

Krijimi i flukseve monetare është realizuar kryesisht në valutë. Rreth 1/2 e fluksit të ofertës së parasë me bazë vjetore ka marrë formën e depozitave në valutë në sistemin bankar. Në fund të muajit maj 2007, pesha e depozitave në valutë ndaj M3 është rritur në rreth 31 për qind, kundrejt 29 për qind në fund të vitit 2006. Ecuria e depozitave në valutë, në terma vjetorë, ka ndjekur prirjen rritëse të krijimit të parasë në valutë në ekonomi, kryesisht në sajë të kredisë në valutë. Gjithashtu, prurjet valutore në formën e remitancave kontribuojnë në baza sezonale, në rritjen vjetore të depozitave në valutë.


Përbërësi i dytë kryesor i krijimit të parasë në ekonomi, huamarrja e brendshme, ka qenë faktor përcaktues i sjelljes afatshkurtër të agregatit M2 dhe përbërësit likuid të ofertës monetare, parasë jashtë bankave. Krijimi i depozitave në lekë në sistemin bankar është mbështetur kryesisht në gjenerimin e parasë nga kredia në lekë për sektorin privat, ndërsa

Grafik 25. Rritja vjetore e agregatëve monetarë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 26. Rritja vjetore e M3 dhe e kredisë për ekonominë (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 27. Rritja vjetore e M3 real (majtas) dhe e huamarrjes neto të qeverisë në terma realë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

pesha e parasë jashtë sistemit ndaj M3 ka shënuar rënie në 22.0 për qind në muajin maj, kundrejt 24.2 për qind në muajin dhjetor. Rënia e këtij raporti është pjesërisht sezonale. Në muajin maj të vitit 2006, ky raport shënoi 23.5 për qind ose 1.5 pikë përqindjeje më pak se raporti aktual. Rritja vjetore e depozitave në lekë ka shënuar rreth 12.5 për qind, ndërsa pesha e tyre ndaj M3 rreth 47 për qind. Në tërësi, struktura e ofertës monetare ka tentuar drejt mjeteve më pak likuide, duke influencuar pozitivisht në zbutjen e efekteve potenciale të zgjerimit të M3 në formimin e presioneve inflacioniste.

Grafik 28. Peshja e depozitave në valutë dhe e parasë jashtë bankave ndaj M3.



Burimi: Banka e Shqipërisë.


5.3 ECURIA E KËRKESËS PËR PARA DHE KREDIA PËR EKONOMINË

Kërkesa për mjete monetare ka pasqyruar rritje të qëndrueshme në muajt prill- maj 2007. Përbërësi kryesor i saj, krediti i brendshëm,

ka vijuar të rritet duke marrë nxitje nga kërkesa më e lartë e sektorit privat për fonde. Zgjerimi i kredisë për ekonominë ka dhënë kontributin kryesor në rritjen vjetore të kërkesës për para, me 71 për qind. Kjo ecuri ka balancuar kontributin në rënie që ka dhënë komponenti valutor i saj. Ndërkohë sektori publik ka pasqyruar një kërkesë të moderuar për fonde dhe pozicioni fiskal i qeverisë vazhdon të karakterizohet nga suficiti buxhetor. Fokusimi i sistemit bankar drejt kreditimit të sektorit privat, po ndikon në uljen e vazhdueshme të peshës që zënë pretendimet e bankave ndaj qeverisë, në kreditin e brendshëm në 54 për qind, kundrejt 65 për qind që përbënte një vit më parë.

Kredia për ekonominë edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit po përbën impulsin kryesor në rritjen e kërkesës për mjete monetare. Në fund të muajit maj, kjo kredi arriti në 228 miliardë lekë ose në 24,6 për qind të PBB-së së parashikuar për vitin 2007. Në dy muajt e fundit, rritja e kredisë prej 14 miliardë lekësh ka shfaqur ngadalësim krahasuar me fundin e tremujorit të parë të vitit, duke u përafëruar me parashikimin në programin monetar të Bankës së Shqipërisë. Ritmi i rritjes së kredisë në terma vjetorë është zvogëluar në 55.6 për qind nga 58.7 për qind që kulmoi në muajin mars. Ndërkohë, kredia e re e akorduar gjatë tremujorit të dytë ka ruajtur nivele të larta, prej 20 miliardë lekësh në muaj. Performanca e mirë e kredisë së re, është shoqëruar në nivele të larta të shlyerjes së saj, duke ndikuar në rritjen më modeste të tepricës së kredisë. Muajt e parë të vitit tregojnë për shkurtrim të kohëzgjatjes mesatare të kredive të reja, duke sinjalizuar një rritje më të ngadaltë të tepricës së kredisë, si pasojë e niveleve të larta të shlyerjes për periudhat në vijim.

Grifik 29. Ecuria e kontributeve të përbërësve të kërkesës për para në rritjen vjetore të M3.



Boks 3. Ecuria e kredisë në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore.

Vendet e Evropës Qendrore e Juglindore po përjetojnë prej vitesh një rritje të ndjeshme të kreditimit të sektorit privat nga bankat tregtare. Normat vjetore të rritjes së kredisë janë në nivele të larta, duke u shoqëruar me rritje të ndjeshme të raportit të kredisë për sektorin privat ndaj PBB-së së vendit. Megjithatë, ky raport vazhdon të jetë dukshëm nën nivelin mesatar të shumë vendeve evropiane me sisteme bankare të zhvilluara, ku raporti i kredisë ndaj PBB-së i kalon 100 për qind.

Rritja e ndjeshme e kredisë në vendet e rajonit është nxitur nga stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik, reformimi i sektorëve të ekonomisë, prezantimi i institucioneve të ekonomisë së tregut dhe zbatimi i reformave ligjore (në veçanti detyrimi ligjor për zbatimin e kontratave). Rritja e shëndetshme ekonomike i ka dhënë shtysë zgjerimit të ndjeshëm të aktivitetit kreditues,

duke ndikuar në pritshmërinë për rritjen e të ardhurave individuale dhe të fitimeve. Në këtë mënyrë, kjo rritje ka inkurajuar zëvendësimin në kohë të kursim/konsumit, duke nxitur më tej kreditimin.

Tabelë 1. Ecuria e treguesve kryesorë të aktivitetit kreditues për vendet e rajonit*.

| Vendet | Kredia | Rritja vjetore | Kredi në valutë /PBB | Kredi për individët /PBB | Kredi për pas. Paluajtshme /PBB | Normat e interesit | Kr. Me probleme / totalit |
|-----------------------|--------------|----------------|----------------------|--------------------------|---------------------------------|--------------------|---------------------------|
| | për qind PBB | | | | | kredive | |
| Bullgari | 49.1 | 30.7 | 22.8 | 17.7 | 7.6 | 8.4 | 2.2 |
| Rumani | 26.3 | 59.3 | 12.5 | 11.8 | 2.3 | 13.9 | 8.5 |
| FYROM | 31.6 | 33 | 8.3 | 10.4 | 1.4 | 10.7 | 7.6 |
| Shqipëri ² | 23.4 | 58.9 | 16.9 | 7.9 | 4.6 | 14.1 | 3.3 |
| Serbi | 28.7 | 13.9 | 13.5 | 10.2 | 21.3 | 15.9 | 24 |
| Kroaci | 74.4 | 22.4 | 60 | 39.5 | na | 9.1 | 2 |
| Poloni | 33.3 | 31 | na | 18.4 | 5 | 7.8 | 6.6 |
| Çeki | 37 | 21.4 | 16.5 | 17 | 12 | 7.2 | 3.6 |
| Mesatare e rajonit | 38.92 | 33.83 | 22.33 | 16.25 | 7.44 | 12.02 | 9.12 |

*Të dhënat janë për muajin mars 2007 (nëse s'referohen ndryshe).

2. Të dhëna të muajit maj 2007.

Burimi: Southeastern Europe and Mediterranean emerging market economies bulletin vol 8, buletini ekonomik NBG, si dhe buletinet ekonomike të bankave qendrore.

Sikurse vihet re edhe nga tabela, aktiviteti kreditues në Shqipëri shfaq ritme të larta rritjeje në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit. Normat vjetore të rritjes dy vitet e fundit janë më të lartat ndër vendet e tjera të Evropës Qendrore Juglindore. Megjithatë, Shqipëria ka raportin më të ulët kredi/PBB ndër vendet e rajonit. Niveli i ulët i raportit kredi/PBB tregon se ka vend për thellim të mëtejshëm financiar dhe rritje të mëtejshme të kredisë.


Zhvillimet e kreditimit në vendet e Evropës Qendrore Juglindore mund të interpretohen kryesisht si një manifestim i thellimit të mëtejshëm të ndërmjetësimit financiar. Por, në të njëjtën kohë zgjerimi i kredisë me hapa të shpejtë dhe vazhdimi i tij për një kohë të gjatë, në shumë prej vendeve nënkupton rritje të rrezikut. Situata e stabilitetit financiar në këto vende mbetet pozitive, por tipari i rritjes së shpejtë të kredisë, kërkon vëmendje të lartë nga ana mbikëqyrëse, që cilësia e kredisë të mbetet e mirë. Nga ana makroekonomike, procesi i shpejtë i kreditimit ka nxitur boom-in në kërkesë. Si rrjedhim, në disa vende të cilat kanë shënuar ritme të larta të vazhdueshme të rritjes së kredisë, deficitit i llogarisë korente ka shkuar përtej niveleve të qëndrueshme në një periudhë të gjatë kohe. Rreziku i madh i përshpejtimit të kredisë, ka qenë objekt i masave që kanë marrë politikëbërësit për ta mbajtur atë sa më pranë niveleve të pranueshme për stabilitetin makroekonomik të përgjithshëm të vendit.

Literatura:

P. Backé, B. Égert & T. Zumer, 2006: "Fast credit expansion in central and eastern europe: catching-up, sustainable financial deepening or bubble?"


P. Backé, & T. Zumer, 2005: "Focus on transition" OENB, Vëllimi 2.

Grafik 30. Ecuria e aktivitetit kreditues.



Struktura e kredisë sipas monedhave është e dominuar nga kredia në valutë. Kjo kredi gjatë tremujorit të dytë ka ruajtur të njëjtat ritme rritjeje, sikurse edhe në muajt e parë të vitit, me 53 për qind në terma vjetorë. Kontributin kryesor në rritjen e saj e ka dhënë kredia për biznese, megjithëse kreditimi i individëve në valutë shfaq ritme më të larta. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit, vihet re përmirësim i lehtë i portofolit të kredisë në lekë, i cili arriti në 28.6 për qind në muajin maj. Ritmet vjetore të rritjes së kredisë në lekë vazhdojnë tendencën rënëse në 63.1 për qind në muajin maj, krahasuar me 71.1 për qind të tremujorit të parë. Rritja e kreditimit për individët gjatë tremujorit të dytë, ka favorizuar ecurinë e kredisë në lekë.


Grafik 31. Ecuria e rritjes vjetore të kredisë sipas monedhave.



Kërkesa e kompanive private për kredi përbën dhe nxitësin kryesor të rritjes së kredisë. Në fund të muajit maj kredia për biznese arriti në 16 për qind të PBB-së dhe në terma vjetorë, ajo ishte 48 për qind më

e lartë se një vit më parë. Ritmet e rritjes së portofolit të kredisë për bizneset kanë qenë në rënie, të ndikuara kryesisht nga nivelet e larta të shlyerjeve të kredive gjatë kësaj periudhe. Gjatë tremujorit të dytë, rritje pasqyroi edhe kredia dhënë sektorit shtetëror. Kjo kredi, e nominuar në euro, u aktivizua si pasojë e përdorimit të linjës së kredisë në një nga bankat e sistemit nga kompania shtetërore KESH. Rritjen më të madhe kjo kredi e dëshmoi në muajin prill, me 1.8 miliardë lekë.


Sipas strukturës së përdorimit kredia dhënë nga sistemi bankar për bizneset, kryesisht është kanalizuar në financimin e blerjeve të pajisjeve. Por, krahasuar me tre muaj më parë vihet re një rritje e kreditimit të sistemit bankar për kapital qarkullues dhe *overdraft*, që arritën në 45.8 për qind të portofolit të kredisë për bizneset. Sipas sektorëve të ekonomisë, tremujori i dytë demonstroi një rritje të moderuar të kreditimit për sektorin e bujqësisë, të ndërtimit dhe të shërbimeve kolektive. Ndërkohë edhe pse sektori i tregtisë paraqitet me portofol kredie të zvogëluar, gjithsesi mbetet sektori më i kredituar i ekonomisë, me 20 për qind të portofolit të kredisë.




Krahasuar me tre muaj më parë, tremujori i dytë i vitit tregoi për rritje të kreditimit të individëve. Në fund të muajit maj, kredia për individët përbënte 34.5 për qind të portofolit në total dhe norma e rritjes së saj arriti në 68.3 për qind. Portofoli i kredisë së individëve për tremujorin e dytë ka demonstruar zgjerim të peshës së kredisë konsumatore për mallra të qëndrueshëm, duke balancuar kështu ngushtimin në peshën e portofolit të kredisë për pasuri të paluajtshme për individët. Megjithatë, kredia për pasuri të paluajtshme përbën zërin kryesor në portofolin e individëve me 61 për qind. Ndërkohë, kredia konsumatore shënoi rritje gjatë tremujorit të dytë duke arritur nivelin e dhjetorit 2006, në 9.1 për qind të portofolit. Sjellja e kredisë konsumatore duket e lidhur ngushtë me periudhat e festave dhe të afrimit të periudhës së pushimeve.

Mjetet valutore neto të sistemit bankar arritën në rreth 2.4 miliardë usd, në fund të muajit maj. Sjellja e mjeteve valutore neto të bankave tregtare ka diktuar ecurinë e përbërësit valutor të kërkesës për para, duke rezultuar në ulje të tij krahasuar me një tremujor më parë. Reduktimi i mjeteve valutore është rezultati neto i një financimi më të lartë të ekonomisë nga bankat në formën e kredive në valutë, me rritjen e depozitave në valutë pranë këtyre bankave. Krahasuar me fundin e vitit 2006, mjetet valutore të bankave tregtare janë ulur me 95.5 milionë usd.

Zhvillimet në rezervën valutore neto të Bankës së Shqipërisë, kanë kontribuar pozitivisht në mjetet valutore neto të sistemit bankar. Rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë arriti në nivelin 1.72 miliardë usd në muajin maj, me një rritje prej 34.7 milionë usd nga fundi i vitit 2006. Ndryshimet në kursin e këmbimit euro/usd kanë patur ndikim të konsiderueshëm në ecurinë e këtyre mjeteve përgjatë kësaj periudhë. Duke përjashtuar efektin e mbiçmimit të euros kundrejt dollarit, rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë rezulton me një ulje prej 4.9 milionë usd.



Bilanci fiskal në muajin maj ka vazhduar të karakterizohet nga një tepriçë buxhetore¹⁶, e cila është rritur me 1.9 miliardë lekë në krahasim me fundin e tremujorit të kaluar. Teprica fiskale ka çuar në një kërkesë të moderuar të qeverisë për mjete monetare. Suficiti fiskal dhe emetimi i letrave me vlerë qeveritare i kanë siguruar qeverisë një tepriçë fondesh prej 14.2 miliardë lekësh, në fund të pesë muajve të parë të vitit. Financimi i brendshëm në muajin maj rezultoi 2.9 miliardë lekë ose vetëm 0.1 miliardë lekë, më shumë se në fund të tremujorit të parë. Për këtë muaj, emetimi i 5.8 miliardë lekëve obligacione 2 dhe 5- vjeçare ka shërbyer në kahun e formimit të flukseve hyrëse qeveritare. Ndërsa emetimi me vlerë më të vogël i bonove të thesarit se vlera e tyre e maturuar dhe investimi prej 6 miliardë lekësh në marrëveshje të anasjellta riblerjeje, në sistemin bankar, kanë shërbyer në kahun e daljes së fondeve qeveritare. Situata e tepriçës së likuiditetit qeveritar pasqyrohet dhe në gjendjen e llogarisë së qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë, e cila rezultoi me një tepriçë prej 5.4 miliardë lekësh në muajin maj ose 2 miliardë lekë më shumë se në fund të muajit mars.



Financimi bruto i qeverisë, gjatë këtyre 5 muajve është realizuar nga rritja e portofolit të letrave me vlerë të individëve dhe institucioneve,

me rreth 5.7 miliardë lekë. Ndërkohë, bankat tregtare kanë vazhduar ta zhvendosin portofolin drejt letrave me vlerë më afatgjata, obligacioneve qeveritare, në të cilat e kanë rritur investimin me 19.2 miliardë lekë. Ndërkohë që kanë reduktuar portofolin e bonove të thesarit me 14.1 miliardë lekë. Nën këto zhvillime, në muajin maj portofoli i bonove të thesarit përbën 73.2 për qind të portofolit të letrave me vlerë qeveritare nga 85.7 për qind, që ishte në të njëjtën periudhë një vit më parë.


5.4 TREGJET FINANCIARE, NORMAT E INTERESIT, KURSI I KËMBIMIT

Aktiviteti tregtues në tregje ka qenë më i zbutur dhe normat e interesit kanë theksuar prirjen rritëse në tremujorin e dytë të vitit. Qëndrimi i politikës monetare në këtë periudhë ka vazhduar të jetë i pandryshuar, duke ruajtur të njëjtën normë bazë interesi, 5.50 për qind, prej muajit nëntor 2006 kur ai u rrit me 0.25 pikë përqindjeje. Në tremujorin e dytë u sinjalizua rritje e normës bazë të interesit (e cila u materializua në fund të muajit qershor), duke formuar pritje të reflektuara pjesërisht në rritjen e normave të interesit në tregun e parasë, në fund të po këtij tremujori . Rritja e normave të interesit në këtë treg në tremujorin e dytë u nxit nga ulja e nivelit të likuiditetit në sistemin bankar (mesatarisht në 3.1 miliardë lekë nga 4.9 miliardë lekë në tremujorin e parë).

ECURIA E LIKUIDITETIT DHE ADMINISTRIMI I TIJ

Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në treg, nëpërmjet instrumentit të saj kryesor, duke tërhequr apo injektuar likuiditet me afat njëjavor e me çmim fiks 5.50 për qind. Kjo ka bërë që në përgjithësi tregjet të kenë operuar me norma të qëndrueshme të interesit, veçanërisht në termat afatshkurtër. Lulatjet e vërejtura të normave të interesit janë ndikuar nga ndryshimet e situatës së likuiditetit në sistem. Në këto kushte, gjatë tremujorit të dytë, krahas instrumentit të saj kryesor, Banka e Shqipërisë, ka përdorur dhe instrumentin e marrëveshjeve të anasjellta

Grafik 35. Normat e interesit afatshkurtra (majtas) dhe afatgjata (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

të riblerjes me afat tremujor, duke injektuar likuiditet në treg. *Yield*-i i marrëveshjeve të anasjella në tremujorin e dytë 2007, në nivel mesatar të ponderuar rezultoi 6.20 për qind. Përkundrazi, gjatë tremujorit të parë të vitit 2007, Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë, duke tërhequr likuiditetin e tepërt, nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes tremujore, *yield*-i mesatar i ponderuar i të cilave rezultoi 6.00 për qind.

Interesat e rezultuar nga përdorimi i instrumenteve të Bankës së Shqipërisë kanë qenë orientues për normat e interesit në tregje. Me përjashtim të interesave të kredive, interesat afatshkurtër gjatë tremujorit të dytë janë luhatur në kufij të ngushtë. Interesat afatgjatë janë rritur në periudhën e rritjes së kërkesës për likuiditete, gjatë tremujorit të dytë 2007.


ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

Në tregun e parasë, korridori përcaktues i interesave të tregut ndërbankar ka mbetur i pandryshuar në nivelet minimale prej 3.75 për qind (interesi i depozitave njëditore) dhe maksimale 7.25 për qind (interesi i kredive njëditore). Brenda këtij korridori interesat e huamarrjeve njëditore në treg ndërbankar, janë luhatur midis kufirit të poshtëm dhe normës bazë të interesit, duke treguar rritje në tremujorin e dytë. Ndryshimi mesatar ditor midis normës bazë dhe interesit njëditor u ul në 0.98 pikë përqindjeje nga 1.24 pikë përqindjeje në tremujorin e parë. Interesat e huamarrjeve shtatëditore janë luhatur rreth normës bazë të interesit, mesatarisht në vlerën 5.66 për qind. Niveli mesatar ditor i huadhënies në tregun ndërbankar u ul në 1.6 miliardë lekë nga 1.8 miliardë lekë, në tremujorin e parë dhe konsiston kryesisht në transaksione njëditore.

Në treg primar¹⁷ *yield*-i i bonove të thesarit tregon rritje prej pothuajse 1 pikë përqindjeje në tremujorin e dytë. Në fund të muajit qershor, *yield*-i 12-mujor arriti përkatësisht në 7.99 për qind nga 7.07 për qind, në fund të muajit mars. Në mars, *yield*-et ranë me rreth 0.50 pikë përqindjeje nga vlera e nëntorit (hera e fundit kur norma bazë e interesit ndryshoi) ndikuar nga teprica e lartë e likuiditetit (si pasojë e efektit sezonal dhe e uljes së kërkesës së qeverisë për mjete), gjë që ndryshoi në të kundërt në tremujorin e dytë. Raporti i kërkesës së qeverisë për financim me bono thesari dhe ofertës së sistemit për investim në to, zbriti në 1:1.2 nga 1:1.9 në tremujorin e parë.


Në rritjen e *yield*-it janë faktorizuar pjesërisht dhe pritjet për rritjen e normës bazë të interesit (kjo u rrit me 0.25 pikë përqindjeje në 28 qershor). *Yield*-i 12-mujor në fund të muajit qershor qëndron rreth 0.40 pikë përqindjeje lart atij të muajit nëntor 2006.

Grafik 36. Normat e interesit në tregun ndërbankar dhe lehtësitë mbështetëse të Bankës së Shqipërisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 37. Yield-et e letrave me vlerë në tregun primar.



Normat afatgjata të interesit në tregun e obligacioneve janë luhatur në varësi të raportit të nevojave për financim të qeverisë dhe kushteve të likuiditetit. Obligacionet dyvjeçare ranë në një minimum prej 7.65 për qind në mars, në të njëjtën linjë me *yield*-et e bonove të thesarit dhe janë rritur në periudhën në vijim (mesatarisht me 0.50 pikë përqindjeje). Obligacionet trevjeçare, të cilat emetohen me frekuencë tremujore, rezultuan 8.05 për qind në muajin prill, kur u refuzuan disa nga ofertat e bankave. Në tregun e depozitave në lekë¹⁸, prirja e përgjithshme ka qenë rritja e normave të interesit përgjatë pesë muajve të parë të vitit për të gjitha afatet. Llogaritur si mesatare e thjeshtë, interesi i depozitave 12-mujore arriti në 5.69 për qind në muajin maj ose 0.14 pikë përqindjeje më lart se në muajin mars dhe 0.28 pikë përqindjeje më lart se muaji dhjetor 2006¹⁹. Në tregun e kredive në lekë²⁰, interesat e kredive në nivel mesatar të ponderuar arritën në 12.7 për qind në muajin maj, 0.23 pikë përqindjeje më pak se në fund të tremujorit të parë²¹. Gjatë kësaj periudhe janë ulur kreditë me afat nga 6 muaj deri në tre vjet, duke nxitur kërkesën për kredi afatshkurtër dhe afatmesme.


Kostoja e ndërmjetësimit, e llogaritur si diferencë midis interesave të kredive në lekë dhe interesave të depozitave në lekë, paraqitet si në tabelën e mëposhtme.

Tabelë 8. Kostoja e ndërmjetësimit në lekë.

| | Dhjetor-06 | Mars-07 | Maj-07 |
|--------------------------|------------|---------|--------|
| Kredi-depozita 6-mujore | 7.54% | 7.73 | 10.32 |
| Kredi-depozita 1-vjeçare | 5.70% | 6.18 | 4.73 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 38. Normat e interesit me afat deri në një vit në Shqipëri dhe në Eurozonë.



Për afatet 6-mujore, kostoja e ndërmjetësimit është rritur në krahasim me fundin e vitit të kaluar dhe fundin e muajit mars 2007, si rezultat i rritjes më të madhe të interesave të kredive në lekë në krahasim me interesat e depozitave në lekë. Ndërkohë, kostoja e ndërmjetësimit është ulur për afatet njëvjeçare, për shkak të uljes së interesave të kredive në lekë. Interesat e depozitave në euro janë luhatur nga muaji në muaj, megjithatë ato kanë ndjekur prirjen rritëse të normave të interesit në Eurozonë. Në muajin maj, norma mesatare e ponderuar e depozitave në euro u rrit në 3.10 për qind ose 0.13 pikë përqindjeje më shumë se në tremujorin e parë dhe 0.30 pikë përqindjeje më shumë se në muajin dhjetor.

Interesat e depozitave në dollarë²² në përgjithësi janë ulur në të gjitha afatet, me përjashtim të interesave të depozitave 1-mujore dhe 36-mujore. Këtu kanë ndikuar dhe për pritshmëritë për uljen e normës bazë të interesit nga Rezerva Federale. Uljen më të madhe e kishin interesat e depozitave pa afat në masën 0.44 pikë përqindje, gjatë dymujorit të dytë 2007.

Interesat e kredisë në valutë janë rritur në muajt prill dhe maj si për monedhën euro ashtu dhe për dollarin amerikan. Në nivel mesatar të ponderuar, interesat e kredive në euro dhe në dollarë arritën në muajin maj përkatësisht në 8.53 për qind dhe 11.81 për qind, ndërkohë që në fund të tremujorit të parë ishin përkatësisht 8.13 për qind dhe 8.86 për qind²³.


KURSI I KËMBIMIT

Tremujori i dytë i vitit 2007 ka njohur një sjellje të ndryshme të lekut krahasuar me një tremujor më parë. Tendanca nënçmuese e lekut ka ndryshuar kah, duke u reflektuar në rënien e shpejtë të euros kundrejt lekut në tregun tonë valutë. Kjo rënie është diktuar fillimisht nga kërkesa e ulët për valutë në tregun valutë (kryesisht në muajin maj). Më pas, një gjallërim i ofertës për valutë në muajin qershor e ka thelluar më tej këtë rënie, duke kundërshtuar edhe presionet mbiçmuese të euros të ardhura nga tregu ndërkombëtar. Krahasuar me fundin e muajit mars, leku është mbiçmuar me 3.7 dhe 4.7 për qind kundrejt euros dhe dollarit, përkatësisht.

Dinamika vjetore e sjelljes së lekut paraqitet e qëndrueshme, me një luhatshmëri të ulët, karakteristike e dy viteve të fundit. Në muajin qershor, leku është mbiçmuar në terma nominalë efektivë vjetorë me 0.7 për qind. Ambienti makroekonomik, gjatë pjesës së parë të vitit ka mbështetur sjelljen e qëndrueshme të lekut. Rritja e kërkesës së ekonomisë, e shoqëruar me rritjen e deficitit të llogarisë korente, gjatë kësaj periudhe, ka sjellë presione nënçmuese për lekun. Po në këtë kohë, ka ushtruar presion dhe ngushtimi i diferencës së normave të interesit lekë-valutë.


Nga ana tjetër, nivelet e ulëta të inflacionit dhe pritjet e ulëta për të kanë mbështetur vlerën e lekut. Më së fundi, rritja e normës së interesit nga Banka e Shqipërisë, pritet të rrisë diferencën e normave të interesit, duke siguruar mbështetje për pozitat e lekut.

Grafik 39. Ndryshimet vjetore të lekut në terma nominalë efektivë (NEER²⁴).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 40. Ecuria ditore e lek/euro dhe lek/usd.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Oferta sezonale, tashmë e ndjerë në tregun valutor, ka ushtruar gjithashtu presione mbiçmimi për lekun. Ecuria e kursit të këmbimit në të ardhmen do të varet nga kushtet makroekonomike dhe ndikimi i faktorëve të lartpërmendur në ofertën dhe kërkesën për valutë.



6. ECURIA E EKONOMISË GJATË VITIT 2007

Zhvillimet makroekonomike gjatë vitit 2007 kanë shënuar dinamizëm të aktivitetit ekonomik të sektorit privat, kundrejt parashikimeve të fillimvitit. Kështu, rritja e kredisë për sektorin privat e parashikuar për vitin 2007 pritet të rrisë ritmin vjetor të ofertës monetare dhe të ndikojë në përkeqësimin e llogarisë korente. Në sektorin publik, kuadri vjetor i zhvillimeve fiskale nuk parashikon ndryshime kundrejt parashikimeve të fillimvitit. Megjithatë, përqendrimi i huamarrjes së brendshme të sektorit publik në gjysmën e dytë të vitit, do të shtrëngojë kushtet e likuiditetit në ekonomi për vitin 2007, duke ushtruar presione në ecurinë e normave të interesave. Pas një vlerësimi analitik të faktorëve makroekonomikë, në muajin qershor, Banka e Shqipërisë ka vepruar në kahun shtrëngues të politikës monetare duke rritur normën bazë të interesit në 5.75 për qind. Kjo rritje synon ruajtjen e pritshmërive inflacioniste, në përmbushje të objektivit të inflacionit. Në përputhje me këto zhvillime, parashikimet aktuale të rritjes ekonomike dhe të normës së inflacionit për vitin 2007 mbeten të pandryshuara.

Tabelë 9. Treguesit kryesorë makroekonomikë.

| | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006* | 2007° | 2008° |
|------------------------------|----------------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Treguesit e ekonomisë reale | (në pikë përqindjeje) | | | | | | |
| Rritja PBB | 2.9 | 5.7 | 5.9 | 5.5 | 5.0 | 6.0 | 6.0 |
| IÇK vjetor (mesatar) | 5.2 | 2.4 | 2.9 | 2.5 | 2.4 | 3.0 | 3.0 |
| PBB nominale (miliardë lekë) | 624.7 | 682.7 | 766.1 | 836.6 | 896.3 | 980.0 | 1,075 |
| Treguesit fiskalë | (në përqindje ndaj PBB-së) | | | | | | |

| | | | | | | | |
|--|----------------------------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Deficiti fiskal (me grante) | -6.6 | -4.5 | -5.1 | -3.6 | -3.2 | -3.9 | -3.9 |
| Huamarrja e brendshme | -3.3 | -2.9 | -2.3 | -2.7 | -2.3 | -2.0 | -2.3 |
| Të ardhura | 24.7 | 24.5 | 24.1 | 24.4 | 25.2 | 25.9 | 26.4 |
| Shpenzime | 31.4 | 29.0 | 29.2 | 28.0 | 28.5 | 29.8 | 30.3 |
| Sektori i jashtëm | | | | | | | |
| Deficiti tregtar (milionë eur) | -1,214 | -1,248 | -1,307 | -1,617 | -1,752 | -1,985 | -2,031 |
| Deficiti llog. korente (% PBB) ²⁶ | -7.2 | -5.3 | -3.9 | -6.5 | -5.8 | -7.4 | -6.5 |
| Treguesit monetarë | (në përqindje ndaj PBB-së) | | | | | | |
| Oferta monetare (% PBB) | 65.3 | 65.0 | 65.7 | 68.4 | 74.4 | 79.0 | 83.3 |
| Kredia për sektorin privat | 6.4 | 7.7 | 9.4 | 14.9 | 21.8 | 28.7 | 35.0 |
| Interesi i bonove thesarit 12-m | 12.0 | 9.5 | 8.1 | 6.9 | 7.8 | -- | -- |

* Të dhëna paraprake. ° Parashikime.

** Deficiti primar përjashton shpenzimet e interesave të borxhit të qeverisë.

Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, INSTAT.

SEKTORI MONETAR DHE BILANCI MAKROEKONOMIK

Kërkesa për para në ekonomi ka shënuar rritje përtej parashikimeve fillestare gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit. Ritmet e kredidhënies rezultojnë më të larta në sajë të rritjes së kërkesës për financimin nga sipërmarrja private si dhe të zbehjes së dominimit të huamarrjes së sektorit publik. Banka e Shqipërisë ka rishikuar parashikimin për rritjen vjetore të kredisë në 85 miliardë lekë, kundrejt parashikimit prej 63 miliardë lekësh në fillim të vitit. Pas këtij rishikimi, pesha e stokut të kredisë për ekonominë ndaj PBB-së, në fund të vitit 2007, parashikohet në rreth 29 për qind. Ndonëse huamarrja e brendshme e sektorit publik mbetet e njëjtë, flukset monetare të krijuara nga huamarrja e brendshme në sektorin bankar pritet të rezultojnë më të larta²⁷. Ky parashikim kuzhtëzohet nga realizimi brenda vitit i shpenzimeve të sektorit publik. Kërkesa më e lartë për mjete monetare, kryesisht e sektorit privat, çoi në rishikimin e parashikimit të rritjes vjetore të ofertës monetare në rreth 16.3 për qind, kundrejt parashikimit të fillimvitit prej 11.9 për qind.

Ecuria e pritur e treguesve monetarë kërkon një politikë monetare të kujdesshme që synon ruajtjen e nivelit të normave të interesave, në përputhje me një raport të balancuar të kursimeve në ekonomi kundrejt të ardhurave kombëtare. Ritmet e larta të kredidhënies kanë ndikuar në ekuilibrin e kursim-konsumit dhe në pozicionin e jashtëm makroekonomik. Kështu, norma e kursimeve në ekonomi për vitin 2007, parashikohet në 18.3 për qind të PBB-së kundrejt parashikimit prej 19.9 për qind në fillim të vitit. Në kushtet e një niveli të pandryshuar të investimeve të parashikuara prej rreth 26 për qind të PBB-së, norma e financimit të jashtëm është rritur në rreth 7.4 për qind të PBB-së kundrejt rreth 6.2 për qind, të parashikuar më parë²⁸. Kjo normë përbën përkeqësim të deficitit të llogarisë korente. Gjatë këtij viti, ajo pritet të pasqyrohet në rritjen e deficitit tregtar.

Ritmet aktuale të kredidhënies në ekonomi ndikojnë në prirjen rritëse të normës së konsumit në ekonomi. Këta faktorë - ritmet e larta të kredidhënies dhe rritja e konsumit - tentojnë të krijojnë presione inflacioniste në ekonomi në periudhën afatmesme. Gjithashtu, efekti i

tyre shprehet në rënien e normës së kursimeve kundrejt të ardhurave kombëtare, duke përkeqësuar llogarinë korente dhe duke krijuar premisa për çekuilibrim në tregun e kursit të këmbimit, në të ardhmen. Akumulimi i këtyre faktorëve dhe materializimi i mëtejshëm i tyre do të cënonte qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike në perspektivë. Banka e Shqipërisë e konsideron një politikë monetare të orientuar drejt rritjes së normës aktuale të kursimeve, si një faktor pozitiv në qëndrueshmërinë makroekonomike në periudhën afatmesme.

SHËNIME

¹ Global PMI Input Price Index llogaritet nga JLMorgan dhe NTC Economics në bashkëpunim me ISM dhe IFPSM.

² DG ECFIN, në mënyrë të rregullt kryen vrojtime për të vlerësuar ecurinë e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë për vendet anëtare të BE dhe për vendet aplikante për t'u anëtarësuar. Këto vrojtime mbulojnë sektorin e industrisë, shërbimeve, tregtisë me pakicë, ndërtimit dhe konsumatorëve dhe nëpërmjet tyre llogariten kryesisht treguesit e besimit të biznesit dhe të konsumatorit. Një tregues tjetër i rëndësishëm është indeksi i zhvillimeve në sektorin e industrisë, PMI, ku vlerësohet ecuria e prodhimit, e porosive të reja, e çmimit të lëndës së parë dhe e punësimit.

³ Bosnjë Hercegovinë, Kroaci, Mal i Zi, Maqedoni, Serbi dhe Shqipëri.

⁴ Interesat për Bosnje Hercegovinën dhe Kroacinë janë mesatarë afatgjatë të ponderuar, për Serbinë mesatare totale e ponderuar dhe për Maqedoninë interesa të ponderuar për kredinë dhe depozitat në denar. Për Greqinë dhe Italinë është dhënë norma e depozitave për individë me maturitet deri në një vit, dhe norma interesit për kredinë e re për shtëpi. Për Kosovën jepet interesi i depozitave për individë, me maturim deri në një vit dhe norma e interesit të kredive konsumatore.

⁵ I matur kundrejt 24 partnerëve kryesorë tregtarë të Eurozonës.

⁶ Tregues i vlerësuar dhe i llogaritur nga personeli i Bankës së Shqipërisë.

⁷ Si deflator është përdorur indeksi përkatës në IÇK.

⁸ Në kushtet e një informacioni të kufizuar dhe të fragmentarizuar për degën e bujqësisë, dhe vetëm në bazë të vlerësimeve paraprake të ekspertëve të kësaj fushe, ky gjykim duhet marrë me rezervë.

⁹ Për këtë rubrikë u përgjigjën rreth 615 biznese të sektorëve të prodhimit, të ndërtimit dhe të shërbimeve.

¹⁰ Për këtë rubrikë u morën në konsideratë vetëm pjesa e të intervistuarve që deklarohen si të punësuar në sektorin privat dhe shtetëror. Të përgjigjurit ishin rreth 700 konsumatorë.

¹¹ Në nënshportën e Indeksit bazë të Çmimeve të Konsumit, pesha e normalizuar e nëngrupit "Bukë dhe drithëra", është rreth 10 për qind.

¹² Qumësht, djathë dhe vezë.

¹³ Ecuria e çmimeve të mallrave të tregtueshëm përcaktohet nga niveli i çmimeve në vendet partnere në tregti, dhe efekti i tyre përcillet ose amplifikohet nëpërmjet kursit të këmbimit.

¹⁴ Objektivat sasiorë të Bankës së Shqipërisë janë pjesë e marrëveshjes së re PRGF/EFF 2006-2008 e nënshkruar midis Qeverisë Shqiptare, FMN-së dhe Bankës së Shqipërisë në muajin janar të vitit 2006, dhe e rishikuar së fundi në muajin maj të vitit 2007.

¹⁵ Objektivat në tremujorin e tretë dhe atë të katërt përcaktohen si shumë e flukseve monetare dhe bazës së muajit dhjetor 2006. Për tremujorin e parë, baza e llogaritjes është muaji dhjetor 2005. Ndryshimi i bazës rezulton në një nivel më të lartë të objektivave sasiorë për muajt shtator dhe dhjetor 2007.

¹⁶ Shih pjesën e sektorit fiskal për vlerën e suficitit buxhetor dhe komponentëve të tij.

¹⁷ Shih: Shtojca statistikore, Tregjet Financiare, Tabela "Normat e interesit në fund të muajit dhe ndryshimi i tyre me periudhat e mëparshme".

¹⁸ Të dhënat më të fundit i përkasin muajit maj 2007.

¹⁹ Interesi i ponderuar rezulton në ulje në muajt maj dhe prill, si pasojë e ndryshimit të strukturës sipas peshave të fluksit të ri të depozitave.

²⁰ Të dhënat më të fundit i përkasin muajit maj 2007.

²¹ Shih: Shtojca statistikore, Tregjet Financiare: Tabela "Normat e interesit dhe ndryshimi i tyre në tregun e depozitave dhe të kredive në lekë".

²² Shih: Shtojca statistikore, Tregjet Financiare; Tabela "Normat e interesit të depozitave në valutë."

²³ Shih: Shtojca statistikore, Tregjet Financiare; Tabela "Normat e interesit të kredive në valutë."

²⁴ NEER – kursi nominal efektiv i këmbimit, i llogaritur kundrejt dy monedhave sipas një peshe të përafërt që zënë në tregtinë me jashtë, euro (80 për qind) dhe usd (20 për qind). Një rritje e NEER do të thotë mbiçmim i lekut.

²⁵ Llogaritur si mesatare tremujore e luhatshmërisë së kursit të këmbimit. Luhatshmëria e kursit të këmbimit është matur nga treguesi i devijimit standard.

²⁶ Të dhënat të rivlerësuara për serinë e deficitit të llogarisë korente që prej vitit 2002.

²⁷ Kjo rritje është rezultat i realizimit, në muajin janar të këtij viti, i shpenzimeve të parashikuara për vitin 2006.

²⁸ Parashikimi i investimeve është rishikuar lehtësisht në rënie - 25.7 për qind kundrejt parashikimit prej 26.0 për qind të PBB-së, në fillim të vitit. Norma e financimit të jashtëm është deficiti i llogarisë korente.

SHTOJCË STATISTIKORE

INFLACIONI

Tabelë 1. Norma vjetore e inflacionit (në përqindje).

| | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 |
|---------|------|------|------|------|------|------|------|
| Janar | 2.2 | 6.5 | 0.0 | 3.3 | 3.3 | 1.4 | 2.9 |
| Shkurt | 1.5 | 7.6 | 1.1 | 4.4 | 1.8 | 1.3 | 2.9 |
| Mars | 2.9 | 7.5 | 1.3 | 4.0 | 1.6 | 1.5 | 2.7 |
| Prill | 3.0 | 6.5 | 2.3 | 3.2 | 1.3 | 2.4 | 1.9 |
| Maj | 2.5 | 4.6 | 2.8 | 2.6 | 2.0 | 3.1 | 1.4 |
| Qershor | 4.0 | 3.7 | 2.6 | 2.9 | 2.9 | 2.4 | 2.0 |
| Korrik | 5.6 | 4.2 | 3.0 | 3.1 | 1.8 | 3.2 | |
| Gusht | 4.1 | 5.5 | 3.0 | 2.7 | 2.3 | 2.9 | |
| Shtator | 3.5 | 5.3 | 2.8 | 2.0 | 3.1 | 2.6 | |
| Tetor | 1.8 | 5.8 | 2.9 | 2.0 | 3.3 | 2.3 | |
| Nëntor | 2.8 | 3.7 | 3.4 | 2.2 | 3.0 | 2.9 | |
| Dhjetor | 3.5 | 1.7 | 3.3 | 2.2 | 2.0 | 2.5 | |
| Mesatar | 3.1 | 5.2 | 2.2 | 3.0 | 2.4 | 2.4 | 2.5 |

Burimi: INSTAT.

Tabelë 2. Kontributi në inflacionin total i grupeve përbërëse të shportës.

| | Qershor - 06 | Korrik - 06 | Gusht -06 | Shtator -06 | Tetor -06 | Nëntor -06 | Dhjetor - 06 | Janar -07 | Shkurt -07 | Mars - 07 | Prill -07 | Maj -07 | Qershor -07 |
|---------------------------------|-----------------|----------------|--------------|----------------|--------------|---------------|-----------------|--------------|---------------|--------------|--------------|------------|----------------|
| Ushqime dhe pije joalkolike | 0.80 | 1.86 | 0.51 | -0.45 | -0.59 | 0.45 | 0.09 | 0.66 | 0.70 | 0.32 | -0.51 | -0.81 | -0.27 |
| Qira,ujë, lëndë djegëse,energji | 1.04 | 0.88 | 1.78 | 2.32 | 2.19 | 1.91 | 1.87 | 1.70 | 1.70 | 1.84 | 1.85 | 1.71 | 1.27 |
| Transport | 0.24 | 0.19 | 0.13 | 0.10 | 0.09 | 0.08 | 0.05 | 0.02 | 0.01 | 0.04 | 0.04 | -0.02 | -0.55 |
| Hotele, kafe dhe restorant. | 0.22 | 0.16 | 0.18 | 0.18 | 0.15 | 0.15 | 0.14 | 0.14 | 0.17 | 0.14 | 0.15 | 0.23 | 0.25 |
| Të tjera | 0.15 | 0.15 | 0.24 | 0.40 | 0.40 | 0.32 | 0.40 | 0.34 | 0.35 | 0.35 | 0.35 | 0.30 | 0.30 |
| Totali | 2.45 | 3.24 | 2.84 | 2.55 | 2.24 | 2.91 | 2.55 | 2.86 | 2.93 | 2.69 | 1.88 | 1.41 | 2.00 |

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

TREGUESIT MONETARË

Tabelë 3. Ecuria e treguesve monetarë (në miliardë lekë).

| | Maj- 07 | Ndryshimi mujor | | Ndryshimi vjetor | |
|-----------------------|---------|-----------------|-----------|------------------|-----------|
| | | Absolut | Përqindje | Absolut | Përqindje |
| Paraja jashtë bankave | 151.7 | -1.2 | -0.8 | 13.4 | 9.7 |
| Depozitat totale | 536.9 | 1.2 | 0.2 | 87.0 | 19.3 |
| - në lekë | 323.6 | 0.8 | 0.2 | 35.9 | 12.5 |
| - në valutë | 213.3 | 0.4 | 0.2 | 51.1 | 31.5 |
| Depozita pa afat | 141.1 | 0.7 | 0.5 | 6.9 | 5.1 |
| - në lekë | 73.5 | -0.6 | -0.7 | -9.1 | -11.0 |
| - në valutë | 67.5 | 1.2 | 1.8 | 15.9 | 30.8 |
| Depozita me afat | 395.8 | 0.5 | 0.1 | 80.1 | 25.4 |
| - në lekë | 250.1 | 1.3 | 0.5 | 44.9 | 21.9 |
| - në valutë | 145.8 | -0.8 | -0.5 | 35.2 | 31.8 |
| M1 | 225.2 | -1.7 | -0.8 | 4.4 | 2.0 |
| M2 | 475.3 | -0.4 | -0.1 | 49.3 | 11.6 |

| | | | | | |
|---------------|-------|------|------|-------|------|
| M3 | 688.6 | 0.0 | 0.0 | 100.4 | 17.1 |
| Baza monetare | 209.5 | -2.0 | -0.9 | 18.8 | 9.9 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4. Ecuria e treguesve të MVN sipas grupeve kryesore, maj 2007 (në milionë usd).

| | Maj - 07 | ndryshimi mujor | ndryshimi vjetor |
|---------------------|----------|-----------------|------------------|
| Mjete valutore neto | 2,390.0 | - 70.8 | 192.4 |
| Mjete valutore | | | |
| BSH | 1,826.7 | - 19.0 | 257.1 |
| BPD | 1,147.1 | - 33.3 | 218.2 |
| Detyrimet valutore | | | |
| BSH | 103.2 | - 0.9 | - 4.2 |
| BPD | 480.6 | 19.4 | 287.1 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5. Ecuria e treguesve të Kredisë Neto për Qeverinë sipas grupeve kryesore.

| | Maj-07 | Ndryshime mujore | Ndryshime vjetore |
|-------------------------------------|-----------|------------------|-------------------|
| Pretendime ndaj qeverisë neto | 291,753.4 | - 22.25 | 23,733.6 |
| Banka e Shqipërisë | 48,407.9 | 3,627.5 | - 2,545.2 |
| BPD | 243,345.5 | -3,649.7 | 26,278.8 |
| Depozita pranë Bankës së Shqipërisë | 6,190.6 | - 3,313.4 | - 638.6 |
| Deficiti buxhetor | | | |
| | 5,261.0 | 557.7 | - 3,729.8 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Ecuria e disa treguesve kryesorë.

| | 2004 | Qershor -05 | Dhjetor -05 | Qershor -06 | Dhjetor -06 | Mars -07 | Prill - 07 | Maj -07 |
|--|-------|-------------|-------------|-------------|-------------|----------|------------|---------|
| Oferta e parasë (në miliardë lekë) | 507.2 | 541.8 | 578.04 | 594.5 | 674.3 | 686 | 688.6 | 688.6 |
| Kredi e brendshme (në % ndaj M3) | 68.9 | 69.9 | 70.03 | 71.0 | 71.8 | 73.9 | 74.6 | 75.5 |
| Kredi për qeverinë (në % ndaj M3) | 55.1 | 52.2 | 48.94 | 45.3 | 43.4 | 42.8 | 42.4 | 42.2 |
| Kredi për ekonominë (në % ndaj M3) | 13.8 | 17.7 | 21.10 | 25.71 | 28.4 | 31.1 | 32.2 | 33.1 |
| Kredi për ekonominë (% ndaj totalit të aktiveve) | 16.9 | 20.8 | 25.11 | 28.7 | 31.3 | 33.6 | 34.5 | 35 |
| Kredi për ekonominë (në % ndaj PBB) | 9.0 | 11.2 | 14.57 | 17.6 | 21.3 | 23.4 | 24.1 | 24.6 |
| Raporti kredi / depozita (në %) | 19.0 | 23.6 | 28.47 | 33.7 | 37.4 | 40.1 | 41.4 | 42.4 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 7. Tregues të tepicës së kredisë në përqindje ndaj totalit.

| | 2003 | 2004 | 2005 | T1-06 | T2- 06 | T3 -06 | T4 -06 | Mars-07 | Prill - 07 | Maj-07 |
|--------------------------------------|------|------|-------|-------|--------|--------|--------|---------|------------|--------|
| Teprica e kredisë (në miliardë lekë) | 50.7 | 69.3 | 121.6 | 134.6 | 152.8 | 165.3 | 191.2 | 213.6 | 221.7 | 227.9 |
| Kredi për individët | 24.5 | 30.6 | 32.3 | 31.9 | 32.3 | 33.3 | 33.4 | 33.8 | 34.2 | 34.6 |
| Kredi për sektorin privat | 75.5 | 69.4 | 67.7 | 68.1 | 67.6 | 66.7 | 66.5 | 66.2 | 64.7 | 64.4 |
| Kredi afatshkurtër | 46.0 | 34.0 | 32.3 | 32.5 | 31.1 | 30.0 | 29.6 | 30.5 | 30.7 | 31.1 |
| Kredi afatmesme | 33.3 | 36.0 | 29.7 | 30.0 | 31.2 | 32.6 | 31.6 | 30.6 | 30.2 | 29.7 |
| Kredi afatgjatë | 20.7 | 30.0 | 37.9 | 37.5 | 37.7 | 37.4 | 38.8 | 38.9 | 39.1 | 39.3 |
| Lekë | 19.6 | 19.5 | 26.6 | 26.0 | 28.2 | 29.8 | 28.9 | 28.0 | 28.1 | 28.6 |
| Valutë | 80.4 | 80.5 | 73.4 | 74.0 | 71.8 | 70.2 | 71.1 | 72.0 | 71.9 | 71.4 |

Burimi: Banka e Shqipërisë

Tabelë 8. Tregues të kredisë së re në përqindje ndaj totalit.

| | Total 2004 | 2005 | | | | 2006 | | | | Mars- 07 | Prill- 07 | Maj-07 |
|--------------------------------|---------------|------|------|------|------|------|------|------|------|-------------|--------------|--------|
| | | T1 | T2 | T3 | T4 | T1 | T2 | T3 | T4 | | | |
| Kredia e re (në miliardë lekë) | 99.7 | 22.1 | 32.8 | 32.1 | 32.9 | 29.4 | 35.7 | 35.8 | 53.9 | 18.9 | 20.2 | 20.2 |
| Kredi afatshkurtër | 62.54 | 53.2 | 47 | 47.4 | 48.7 | 44.2 | 42 | 45.8 | 46.7 | 52.1 | 55.1 | 48.3 |
| Kredi afatmesme | 22.53 | 22.4 | 31 | 30.3 | 25.6 | 30.1 | 33 | 31.2 | 27.4 | 23.9 | 20.5 | 19.7 |
| Kredi afatgjatë | 14.93 | 24.4 | 22 | 22.2 | 25.7 | 25.7 | 26 | 23.0 | 25.9 | 24.0 | 24.4 | 32.0 |
| Kredi në lekë | 32.59 | 30.1 | 32.8 | 30.2 | 31.4 | 27.7 | 35 | 39.6 | 26.2 | 35.5 | 32.1 | 37.8 |
| Kredi në valutë | 67.41 | 70 | 67.2 | 69.8 | 68.6 | 72.3 | 65 | 61.4 | 73.8 | 64.5 | 67.9 | 62.2 |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 9. Shpërndarja e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë (në përqindje të totalit).

| | T1- '05 | T2- '05 | T3- '05 | T4- '05 | T1- '06 | T2- '06 | T3- '06 | T4- '06 | Mars- 07 | Prill- 07 | Maj- 07 |
|---|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|-------------|--------------|------------|
| Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura | 1.3 | 1.5 | 2.4 | 2.7 | 2.2 | 0.9 | 0.7 | 0.7 | 0.6 | 0.7 | 0.8 |
| Peshkimi | 0.01 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.1 | 0.11 | 0.1 | 0.4 | 0.1 | 0.1 |
| Industria nxjerrëse | 2.35 | 0.6 | 0.5 | 0.5 | 1.4 | 2.3 | 1.0 | 1.0 | 1.4 | 1.5 | 1.5 |
| Industria përpunuese | 15.8 | 15.6 | 13.9 | 13.8 | 14.2 | 15.3 | 15.5 | 14.3 | 13.4 | 13.2 | 13.0 |
| Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike e gazit dhe e ujit | 6.27 | 2.9 | 2.9 | 2.6 | 2.4 | 1.1 | 1.2 | 1.5 | 1.7 | 2.5 | 2.4 |
| Ndërtimi | 10.6 | 11.2 | 12.8 | 13 | 13.0 | 12.2 | 12.6 | 12.6 | 12.5 | 12.6 | 12.8 |
| Tregtia, riparimi i automobilave dhe artikujve shtëpiakë | 20.5 | 19.1 | 20 | 18.9 | 19.0 | 22.5 | 23.1 | 22.4 | 22.0 | 21.5 | 20.9 |
| Hotele dhe restorante | 2.5 | 4.7 | 4.4 | 4.3 | 4.8 | 4.1 | 3.9 | 3.5 | 3.4 | 3.5 | 3.5 |
| Transporti dhe telekomunikacioni | 2.5 | 1.7 | 1.7 | 1.5 | 1.3 | 1.6 | 1.6 | 2.0 | 2.0 | 1.9 | 1.9 |
| Aktivitetet financiare | 0.2 | 1.1 | 0.7 | 0.8 | 0.7 | 1.3 | 0.7 | 2.1 | 1.9 | 1.9 | 1.9 |
| Shëndeti dhe veprimtaritë sociale | 0.1 | 0.4 | 0.6 | 0.7 | 0.6 | 0.6 | 0.3 | 0.0 | 0.3 | 0.3 | 0.4 |
| Shërbime kolektive, sociale dhe personale | 8.3 | 7.4 | 5.9 | 5.8 | 4.6 | 1.7 | 2.0 | 0.6 | 2.5 | 2.1 | 2.5 |
| Të tjera* | 29.6 | 33.7 | 34.1 | 35.4 | 35.7 | 36.2 | 35.1 | 39.2 | 37.8 | 38.2 | 38.3 |
| Total | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 |

Burimi: Banka e Shqipërisë

*Zëri "të tjera" përfshin kredinë e akorduar disa sektorëve me peshë të vogël në aktivitetin ekonomik të vendit si dhe kredinë për individët. Me prezantimin e ri të formularëve të kredisë është kërkuar një rishikim i shpërndarjes së kredisë sipas sektorëve ku u prezantua rindarja e re.

TREGJET FINANCIARE

Tabelë 10. Normat e interesit në fund të muajit dhe ndryshimi i tyre me periudhat e mëparshme (në pikë përqindje).

| | Qershor'07 | Ndryshimi qershor'07- mars'07 | Ndryshimi mars '07- dhjetor'06 |
|---------------------------------------|--------------------|----------------------------------|-----------------------------------|
| Norma bazë e interesit | 5.50% ¹ | +0.00 | 0.00 |
| Tregu ndërbankar | | | |
| Interesi i tregut ndërbankar 1- ditor | 5.12 | 0.61 | -0.01 |
| Interesi i tregut ndërbankar 7- ditor | 5.67 | -0.01 | 0.44 |
| Tregu primar | | | |
| yield-i i bono thesarit 3- mujore | 5.83 | -0.01 | -0.75 |
| yield-i i bono thesarit 6- mujore | 7.23 | 0.59 | -0.47 |
| yield-i i bono thesarit 12- mujore | 7.99 | 0.86 | -0.64 |
| Tregu i obligacioneve | | | |
| yield-i i obligacioneve 2- vjeçare | 8.20 | 0.55 | -0.75 |
| yield-i i obligacioneve 3- vjeçare | 8.05 | -0.85 | 0.10 |
| yield-i i obligacioneve 5- vjeçare | 9.83 | -0.31 | 0.46 |

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat tregtare.

¹ Norma e re bazë u miratua në 27 qershor me një rritje prej 25 pikë për qind duke arritur në nivelin 5.75 për qind.

Tabelë 11. Normat e interesit dhe ndryshimi i tyre në tregun e depozitave dhe të kredive në Lekë (në pikë përqindjeje).

| | Maj '07 | Ndryshimi maj'07-mars'07 | Ndryshimi mars'07- dhjetor'06 |
|-------------------------------|---------|-----------------------------|----------------------------------|
| Norma bazë e interesit | 5.50 | 0.00 | 0.00 |
| Interesi i depozitave në lekë | | | |
| 1 – mujore | 3.96% | 0.57% | 0.04% |
| 3 – mujore | 3.68% | -0.34% | 0.08% |
| 6 – mujore | 4.55% | -0.09% | 0.00% |
| 12 - mujore | 5.39% | -0.09% | 0.02% |
| 24- mujore | 5.64% | -0.35% | 0.11% |
| 36-mujore | 7.00% | 0.82% | -0.24% |
| Interesi i kredive në lekë | | | |
| Kredi deri në 6 muaj | 14.87% | 2.50% | 0.19% |
| Kredi 6 muaj- 1 vit | 10.12% | -1.54% | 0.50% |
| Kredi 1-3 vjet | 16.69% | -0.29% | -0.72% |
| Kredi mbi 3 vjet | 13.18% | 0.67% | 0.30% |

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

Tabelë 12. Normat e interesit të depozitave në valutë (në pikë përqindjeje).

| | Maj '07 | Ndryshimi maj'07-mars'07 | Ndryshimi mars'07- dhjetor'06 |
|--------------------------------|--------------------|-----------------------------|----------------------------------|
| Fed-norma bazë e interesit | 5.25% | 0.00 | 0.00 |
| Interesi i depozitave në usd | | | |
| 1 – mujore | 3.32% | 0.13% | 0.16% |
| 3 – mujore | 3.61% | -0.02% | 0.19% |
| 6 – mujore | 3.77% | -0.15% | 0.05% |
| 12 - mujore | 4.74% | -0.01% | 0.46% |
| 24 - mujore | 4.68% | -0.11% | -0.07% |
| BQE-norma bazë e interesit | 3.75% ² | 0.00 | +0.25 |
| Interesat e depozitave në euro | | | |
| 1 – mujore | 3.02% | 0.32% | 0.16% |
| 3 – mujore | 3.33% | 0.17% | 0.25% |
| 6 - mujore | 3.37% | -0.06% | 0.14% |
| 12 - mujore | 3.92% | 0.13% | 0.34% |
| 24 - mujore | 4.11% | -0.13% | 0.08% |

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

² U rrit me 0.25 pike përqindjeje në 4.00 për qind në qershor 2007.

Tabelë 13. Normat e interesit të kredive në valutë (në pikë përqindjeje).

| | Maj '07 | Ndryshimi maj'07-mars'07 | Ndryshimi mars'07- dhjetor'06 |
|------------------------------|---------|-----------------------------|----------------------------------|
| Interesat e kredive në usd | | | |
| Kredi deri në 6 muaj | 12.25% | 2.99% | -0.50% |
| Kredi 6 muaj- 1 vit | 9.84% | 0.75% | -0.02% |
| Kredi 1-3 vjet | 12.06% | 5.97% | -3.91% |
| Kredi mbi 3 vjet | 11.00% | 1.79% | 0.15% |
| Interesi mesatar i ponderuar | 11.81% | 2.95% | -0.56% |
| Interesat e kredive në euro | | | |
| Kredi deri në 6 muaj | 7.96% | -0.01% | 0.34% |
| Kredi 6 muaj- 1 vit | 8.33% | 0.61% | -0.73% |
| Kredi 1-3 vjet | 9.51% | 1.41% | -0.35% |
| Kredi mbi 3 vjet | 8.50% | 0.05% | 0.11% |
| Interesi mesatar i ponderuar | 8.53% | 0.40% | -0.05% |

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë.

